pripadnikov naroda, ki ima toliko političnih zapornikov kot jugoslovanski Albanci, obsojenih večidel le zaradi "verbalnih deliktov" in "sovražne propagande", ne moremo pričakovati. iskrenih odgovorov na vprašanje, kaj si mislijo o šovinističnih ukrepih, katerih pobudnik je predsednik občine, v kateri prebivajo, in ki jih podpira tudi vlaga makedonske republike. Ali bi bilo leta 1976 veliko Slovencev, ki bi kakemu neznanemu tujemu novinarju iskreno odgovorili, kaj si mislijo na primer o kočevskem poboju razoroženih domobrantskih vojnih ujetnikov? če bi Marjana Vončina uspela prepričati, da se njeni sogovorniki niso bali, da bi iskreni odgovori na njena vprašanja utegnili priklicati policijske in sodne posledice, in če bi me prepričala, da intervjuvanci niso imeli njenega spraševanja za policijsko provokacijo, bi se mi zdela njena trditev vredna globokega razmisleka. Toda številni stiki z Albanci nam kažejo, da se večina Albancev izogiblje političnim pogovorom z neznanci. In prav imajo; zakaj bi se po nepotrebnu izpostavljal nevarnosti, da jih zaprejo?

Odgovoriti moram še na očitek, da sem s svojim govorom na zboru slovenskih kulturnih delavcev izpostavil vse slovenski narod napadom iz Makedonije. Marjana Vončina si očitno želi obraniti slovenski narod pred napadi zaradi mojega nastopa, saj piše takole:

"že naslednjega dne je odgovorila "Nova Makedonija", osrednje makedonsko glasilo, vendar ne Juretu Deteli, ampak Slovencem. Komentar Vladimirja Tulevskega ima naslov "Suverenost po slovenski meri". V času, ko se napadi n Slovenijo in njene predstavnike stopnjujejo, ko je oči in ušes na preži vse več, se zdi pošteno in prav, da se ob tetovskem primeru nekoliko pomudimo."

Na žalost se moram strinjati z Marjano Vončina, da je slovenski narod v resnici napačen naslov za očitke in jezo, ki jih je vzbudilo moje stališče o tetovskem diskriminacijskem demografskem zakonu. Med Slovenci najbrž ni veliko ljudi, ki se v tem pogledu docela strinjajo z menoj. Novinarja Nove

Makedonije bo verjetno razveselila moja informacija, da sem med Slovenci in med Slovenkami požel nemalo besa in očitkov zaradi svojega nastopa. Temu se ne čudim. Etična občutljivost Slovencev za številne politične probleme se je v zadnjih letih resda močno povečala, toda po številu abortusov še zmeraj spadajo med vodilne narode, zato jih je moj govor dregnil v bolečo točko. Z eno besedo, novinarja Nove Makedonije lahko potolažim, da ima med Slovenci malo takšnih oponentov, kakršen sem jaz. Moja mera za človeško suverenost nikakor ni tipično slovenska, kot zmotno misli; prej bi lahko rekli, da je žirafja ali gamsja, kajti žirafe in gamsi ne poznajo abortusov.

Nihče mi ni rekel, da je govorniški pult v Cankarjevem domu delgatska tribuna. Samo po sebi mi je bilo umevno, da ne govorim v imenu nikogar, ki bi me pooblastil, da v Cankarjevem domu zastopam njegova stališča. Mislim, da je to tudi novinarju Nove Makedonije prekletoto jasno. Priponnim naj še to, da me ni nihče povabil v Cankarjev dom. Šele po končanem zboru kulturnih delavcev sem zvedel, da so organizatorji pred začetkom zбора razposlali 1200 vabil, s katerimi so vabili k udeležbi. Meni niso poslali vabilia, toda mislil sem, da je govorniški pult na razpolago vsakomur, ki zaprosi za besedo. Vsekakor pa naj novinarji Nove Makedonije vejo, da organizatorji zбора kulturnih delavcev ne nosijo niti najmanjše sokrivde in soodgovornosti za moj nastop v Cankarjevem domu.

Toda četudi se moje stališče do tetovskega demografskega zakona razlikuje od stališča večine Slovencev in četudi se moje pojmovanje o razmerjih med vrednotami razlikuje od pojmovanja večine Slovencev, mi vendar nihče nima pravice očitati, da je moje etično stališče protislovensko, in nihče nima pravice distancirati slovenskega naroda KOT CELOTE od mojega etičnega stališča. Nihče nima pravice, da monopolizira CELOTEN slovenski narod z vidika svojega stališča, in da razglaša vse, kar temu stališču nasprotuje, za protislovensko, za tujek v slovenskem telesu. Četudi se ne bi danes

noben Slovenec ukvarjal z istimi problemi kakor jaz, ne bi mogel iz tega nihče sklepati, da v prihodnosti ne bojo o teh problemih Slovenci razpravljali v slovenskem jeziku. Nihče mi ne more odvzeti globoke čustvene vezanosti na številne slovenske pesmi, in globoke pripadnosti spominom na številne subtilne pogovore, ki sem se jih udeležil v slovenskem jeziku - v jeziku, ki sem se ga naučil prvega med vsemi, ki ga najbolje obvladam in ki sem za njegovo kultuvacijo storil več kot za kultivacijo kateregakoli drugega jezika. Skratka: SLOVENEC SEM, in ne najdem besed, s katerimi bi lahko izrazil, kako si želim, da bi to barbarsko ljudstvo, ki mu pripadam, ublažilo svoje brutalne nравi, običaje in ravnanja.

Neka moja izjava z zbora slovenskih kulturnih delavcev pa zasluži, da se z njo samokritično soočim. V Cankarjevem domu sem rekел, da bi slovenske oblastniške ustanove morale obravnavati kot zločinca vsakega zdravnika, ki diskriminiram otrokom odreče brezplačno zdravniško pomoč. To izjavo preklicujem - ne zato, ker bi se mi zdaj zdelo takšno ravnanje zdravnikov manj brutalno kot v času izjave, temveč zato, ker ne želim z zapornimi kaznimi večati trpljenja na tem svetu. Nikakor nočem zapornih kazni za tetovske zdravnike, temveč hočem, da se takoj ukinejo brutalni zakoni, ki sankcionirajo njihovo ravnanje. Mogoče se bo pričujoča samokritika zdela komu pretirano skrupulozna, toda če pomislim, kakšna kazen bi lahko doletela tetovske občinske funkcionarje in zdravnike, mi je hudo zanje, saj vem, da jih ne čaka lahka prihodnost. Četudi se zavzemam za takojšnje prenehanje nacionalnega zatiranja Albancev, bi vendar rad storil vse, kar je v moji moči, da ne bo nikoliprišlo do izbruha maščevalnosti nad zatiralci. Če gledamo post festum na nekatere zgodovinske prevrate, nam postane jasno, da je bilo v obdobjih upravičenega upora proti zatiralcem premalo storjenega, da ne bi maščevalnost do zatiralcev dobila v času zmage nad njimi pošastnih dimenzij. Zato predlagam amnestijo vseh, ki jih je

protialbanska histerija tako zaslepila, da so segli po protiustavnih ukrepih.

Spomnil sem se pesnika in prevajalca Mateja Bora. Popolnoma verjamem, da je v času povojske represije nad Kocbekom pošteno in možato ravnal in da leta 1946, ko je izšla knjiga njegovih pesmi, še ni ničesar vedel o kočevskem masakru razoroženih domobrantskih ujetnikov. Jasno je, da je bil Matej Bor kot intelektualec, pesnik in poznavalec Shelleyeve poezije popolnoma neuporaben za okrutne maščevalne ukrepe in da se je zato politična elita potrudila, da je svoje krvavo maščevanje prikrila pred takšnimi ljudmi. Toda če preberem takšno pesem, kakor je na primer Sinu izdajalcu, moram priznati: tudi Matej Bor je nekaj prispeval k množičnemu besu, ki je po partizanski zmagi dobil svojo zadostitev v pobojih vojnih ujetnikov. Nikakor nočem trditi, da je krivda Mateja Bora primerljiva s krivdo tistih vrhovnih oblastnikov, ki so ukazali pobjoj. Hočem le reči, da mora biti intelektualec v razburkanih političnih obdobjih skrajno pazljiv, da pri svojem političnem angažiranju ne daje s svojim pisanjem potuhe mračnim maščevalnim strastem. Absurdno bi bilo danes očitati Mateju Boru, da je v tem smislu pred petinštiridesetimi leti z dvema ali s tremi pesmimi zabredel v zmoto; s petinštiridesetletne distance ni težko deliti naukov. Upam, da mi Matej Bor ne zameri pričujoče pripombe; do tragike duhovno živih intelektualcev, ki jih je zagrabil okrutni čas, čutim globoko sočutje. Primer Mateja Bora omenjam zato, ker so intelektualci tudi danes na neki način v podobnem položaju. Vendar mi vzbuja optimizem neverjetna potrpežljivost Albancev, s katero že dolgo prenašajo zatiranje, zato upam, da se bojo znali dostojanstveno odpovedati nasilju in maščevalnosti tudi takrat, ko jim bojo vse jugoslovanske ustanove priznavale tiste nacionalne pravice, ki jim pripadajo po mednarodnih konvencijah in po naravnem pravu.

JURE DETELA:

DISKRIMINIMI I FËMIJËVE NË TETOVË

(vazhdim nga numri i kaluar)

Marjana Vonçina refuzon vendosmërisht të mendojë për çështjen e ligjit tetovar se është apo nuk është i drejtuar kundër shqiptarëve për natalitetin e tyre të lartë. Ajo deklaron se të gjithë "më në fund jemi njerëz dhe se varfëria nuk zgjedh midis kombësish". Esenca e çështjes tetovare në të vërtete nuk është diskriminimi i shqiptarëve si pjesëtarë të një populli po diskriminimi i fëmijëve si qytetarë të RSFJ-së. Mirepo Marjana Vonçina me aq këmbëngulje i ikën edhe vetë mendimit se ligji i Tetovës të vështrohet në dritën e pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi. Atëherë kur edhe fëmijët goditën nga diskriminimi, diçka më shtyn të kam një raport skeptik ndaj entuziazmit patriotik; ndërkaq ligji tetovar pa dyshim bie në kontekstin politik të mbylljes së shkollave të mesme shqiptare në disa komuna maqedonase, në kontekstin e rrënimit me dhunë të mureve rrëth shqiptare dhe në kontekstin e dënimive brutale me burg të fëmijëve tetëmbëdhjetëvjeçarë shqiptarë, vetëm për fjälët që i thanë dhe për shkak të angazhimit të tyre për të drejtën që ua siguron edhe Kushtetuta: për të drejtën që të shkollohen në gjuhën e nënave dhe të etërve të tyre. Marjana Vonçinaduhej t'u kushtonte pak rëndësi edhe pohimeve të shtypit serb dhe maqedonas në lidhje me atë se nataliteti i shqiptarëve qenka një komplot irredentist dhe gjëra tjera pa kripe. Ligji tetovar bile u jep përkrahje të plotë shfaqjeve të këtilla të hapura të shovinizmit antishqiptar. Njerëzit që i godet më së shumti ligji tetovar janë pikërisht dhe para së gjithash pjesëtarë të një popullate, e cila në Maqedoni po e pëson keq vetëm për shkak të përkatesisë së saj kombëtare. Marjana Vonçina theksón se madje edhe kryetari i komunës së Tetovës, **Adem Abdullahu, është iniciator kryesor i ligjit demografik tetovar, me kombësi na qenka shqiptarë. Ky fakt mua s'më thotë gjë: me siguri duhet të jetë ndonjëri prej atyre shqiptarëve fatzitë blerë prej shovinisteve serbë e maqedonas për të mbështetur politikën e tyre. Marjana Vonçina gjithashtu pohon se "askush nga të pyeturit, as në qytet as në fshatra, nuk është përgjigjur në fjälët se përpjekjet për pakësimin e lindjeve qenkan brutale dhe as me ato se gjithkush paska të drejtë të ketë aq fëmijë sa dëshiron ose sa mund t'i lindë". Për këtë nuk çuditëm aspak. Prej një populli që ka aq shumë të burgosur politikë, siç janë shqiptarët e Jugosllavise e që janë të dënuar kryesish për "delikte verbale" dhe "propagandë armiqësore", nuk mund të presësh përgjigje të singertë në pyetjen se çfarë menduan për masat kufizuese shoviniste, iniciator i të cilave qenka kryetari i komunës në të cilën jetojnë dhe të cilat i mbështetka edhe pushteti i republikës maqedonase. A do të kishte vallë në vitin 1976 shumë sllovenë që do t'i përgjigjeshin singlerisht ndonjë gazetari të huaj e të panjohur, se çfarë mendojnë, bie fjala, për plojën në Koçevje të domobranëve, robërtë çarmatosur lufte. Nëse Marjana Vonçina do të arrinte të më mbushte mendjen se bashkëbiseduesit e saj nuk kanë pasur frikë se përgjigjet e tyre të singerta në pyetjet e saja nuk do të sillnin për pasojë edhe masa policore e gjyqësore, dhe nëse do të më mbushte mendjen se të intervistuarit nuk i kanë marrë pyetjet e**

saja për provokacione të rëndomta policore e gjyqësore, do të më dukej pohimi i saj i denjë për një shqyrtim të thelle. Mirëpo kontaktet e shumta me shqiptarët na bëjnë me dije se shumica e tyre u ikin bisedave politike me të panjohur. Dhe, a s'kanë, vallë të drejtë? Përse t'i nënshtrohen pa ndonjë shkak rrezikut për t'u burgosur?

Më duhet të merrem edhe me atë vërejtjen se me fjalimin tim në tubimin e punonjësve sllovenë të kulturës, paskam bëre që mbare populli slloven t'i nënshtrohet sulmeve nga Maqedonia. Duket sikur Marjana Vonçina don të marrë në mbrojtje gjithë popullin slloven para sulmeve për shkak të paraqitjes sime, prandaj shkruan kështu:

"Që të nesërmen reagoi "Nova Makedonija", gazeta qendrore maqedonase, mirëpo jo kundër Jure Detelës po kundër sllovenëve. Komenti i Vladimir Tulevskit është titulluar "Sovraniteti sipas mënyrës sllovene". Në kohën kur për herë e më tepër po shkallëzohen sulmet kundër Sllovenisë dhe përfaqësuesve të saj, kur si sytë ashtu veshët janë ngrehur lart drejt tyre, duket e drejtë dhe e ndershme që të merremi pak me rastin e Tetovës".

Për fat të keq më duhet të pajtohem me Marjana Vonçinën se populli slloven vërtetë është një adresë e gabuar për zbrazjen e kritikave dhe të millefit të shkaktuar pre qëndrimit tim ndaj ligjit diskriminues demografik të Tetovës. Ma ha mendja se ndër sllovenët nuk ka edhe aq shumë njerëz që do të pajtoheshin plotësisht me mua. Gazetarin e "Nova Makedonisë" me siguri do ta gëzojë lajmi se unë me qëndrimet e mia, nga ana e sllovenëve e slloveneve kam pësuar jo pak qortime e kam shkaktuar jo pak hidhërimë. Kjo gjë nuk më çudit. Ndjeshmëria etiko-morale e sllovenëve në vitet e fundit për çështjet e shumta politike, është shtuar shumë, mirëpo nga ana e abortimeve sllovenët janë në radhën e popujve që prijnë. Për këtë shkak paraqitja ime ka prekur aty ku dhemb. Me një fjalë, gazetari i "Nova Makedonisë" mund të ngushullohet se në mes të sllovenëve ka fare pak oponentë të tillë si unë. Masa ime për sovranitetin njerëzor assesi nuk është tipike sllovene, siç do të mendonte gabimisht ai; më parë do të thosha se ajo përputhet me qëndrimin e gjirafave a të dhive të egra, ngase as të parat as të dytat s'kanë haber për abortusin.

Askush s'më ka thënë se puliti i oratorit në Cankarjev Dom është ndonjë tribunë e delegatëve. E kisha të qartë se atje s'po flisja në emër të askuji që do të më kishte autorizuar, që në Cankarjev Dom të përfaqësoja qëndrimet e tija. Të vejë në djall se kjo do të duhej t'ishte e qartë edhe për gazetarin e "Nova Makedonisë"! Më duhet të përmend edhe një fakt: askush nuk më ka ftuar atë ditë në Pallatin e Cankarit. Vetëm pas përfundimit të tubimit kam marrë vesh se organizatorët e tij paskëshin shpërndarë 1200 ftesa pjesëmarrjeje. Unë s'kam pasur kurrëfarë ftese, po kam pasur bindjen se foltorja është në dispozicion të çdo qytetari që do të donte të merrte fjalën. Le ta dijnë patjetër gazetarët e "Nova Makedonisë" se organizatorët e tubimit të punonjësve kulturorë nuk mbajnë as më të voglën bashkëpërgjegjësi apo bashkëfajësi për paraqitjen time publike në Cankarjev Dom.

Mirëpo nëse qëndrimi im përkitazi me ligjin demografik tetovar dallohet nga qëndrimi i shumicës së sllovenëve dhe nëse pikëpamja

ime për raportet midis vlerave dallohet nga pikëpamja e shumicës së slloveneve, askush s'ka të drejtë të më qortojë për ndonjë qëndrim timin kundërslloven dhe askush s'ka të drejtë ta distancojë popullin slloven si TËRËSI nga qëndrimi im etik. Askush s'ka të drejtë ta monopolizojë TËRE popullin slloven sipas këndvështrimit dhe qëndrimeve të vetanë mënyrë që gjithçka që s'përputhet ose është kundër atij këndvështrimi, ta shpallë si antisllovene ose si diçka të huaj për trupin slloven. Nëqoftëse sot asnjë qytetar slloven nuk preokupohet me po ato probleme që më preokupojnë mua, askush nuk mund të nxjerë perfundim se edhe në të ardhshmen nuk do të diskutojnë për këto probleme sllovenët në gjuhën e tyre sllovène. Askush nuk mund të mi rrëmbejë lidhjet e forta emocionale për këngët e shumta sllovène dhe përkatesinë time të thellë në kujtimet për bisedat e shumta e subtile ntë cilat kam marrë pjesë në gjuhën time sllovène, në gjuhën që e kam mësuar para gjithë tjerave, të cilën e kam përvetësuar më së miri dhe për kultivimin e së cilës kam bërë më shumë se për kultivimin e cilësdo gjuhë tjetër. Shkurt: JAM SLLOVEN dhe nuk gjej shprehje me të cilën do ta thoja lehtë se sa do të dëshiroja që ky popull barbar të cilit i takoj edhe vetë, ta zbuste natyren e tij të vrazhdët, zakonet dhe mënyrën e sjelljes.

Ndërkaq njëra nga deklaratat e mia në tubimin e punonjësve kulturorë sllovenë meriton një ballafaqim autokritik. Në Pallatin e Cankarit kam thënë midis tjerash se organet e pushtetit slloven duhet ta trajtojnë si kriminel cilindo mjek që fëmijëve të diskriminuar do t'ua refuzonte ndihmën shëndetsore pa pagesë. Këtë deklaratë më duhet ta tërheq- jo sepse një mënyrë e tillë sjelljeje më duket tani më pak brutale se sa në kohën e fjalimit tim, por vetëm se nuk kam dëshire që me burgosje të reja t'i shtoj vuajtjet në këtë botë. Nuk dëshirej kurrësesi dënlime me burg për mjekët tetovarë po dua që menjëherë të hiqen ato ligje brutale që i sankcionojnë veprimet e tyre. Ka mundësi që autokritika ime ti duket dikujt si diçka tepër skrupuloze por kur mendoj se ç'dënlime të rënda mund t'u sjellë ndonjë situatë e re punëtorëve shëndetsorë dhe zyrtarëve të sotëm komunale të Tetovës, ndjej keqardhje për ta, sepse e dijë mirë se e ardhshmjë e tyre s'do të jetë aspak e lumtur. Edhepse angazhohem për një ndërprerje të menjëherëshme të shtypjes kombëtare të shqiptarëve, në të njëjtën kohë do të bëja gjithçka që është në mundësitë e mia që kurre të mos vijë deri tek shpërthimi i hakmarrjes ndaj shtypësve të sotëm. Nëqoftëse i vështrojmë disa kthesa të mëdha historike post festum, na bëhet e qartë se në kohën e rezistencës së arsyeshme kundër shtypësve është punuar fare pak që hakmarrja kundër shtypësve, në çastin e triumfit të merituar, të mos marrë përmasa të përbindëshme. Prandaj propozoj një amnesti për të gjithë ata që histeria antishqiptare i ka verbuaraq shumë, saqë u kapën edhe pas masash antikushtetuese.

Mu kujtua këtu poeti e përkthyesi Matej Bor. Besoj plotësisht se në kohën e represaljeve të luftës ndaj Kocbekut ai është sjellë ndershëmërisht dhe si burrat, dhe se në vitin 1946, kur u botua libri i tij i poezive, akoma nuk dinte asgjë për masakrin koçevjas të robërve të paarmatosur domobranë. Është fare e qartë se Matej Bori, si intelektual, poet dhe njohës i shkëlqyer i poezisë së Shelit, ishte fare i papërdorshëm për masa të egra

ndëshkimore dhe se mu për këtë elita e atëherëshme politike hakmarrjen e vet të përgjakshme e mbante fshehur para njerezve të këtillé. Mirëpo, duke lexuar një poezi të këtillé, siç është për shembull "Djalit të tradhëtarit" më duhet të konstatoj se edhe Matej Bori i ka kontribuar revoltës masive që pas fitores partizane e gjeti përbushjen e vet në likuidimin e robërve të luftës. Assesi nuk dua të pohoj se faji i Matej Borit mund të matet me fajin e pushtetmbajtësve të lartë që urdhëruan masakrin. Vetëm desha të them se në situata të trazuara politike detyrë e intelektualit është që të jetë tejet i kujdeshëm, që gjatë angazhimit të vet politik me shkrimet e veta të mos u mbajë krahun furive të verbëra të hakmarrjes. Do t'ishte absurde të fajësojmë sot Matej Borin, që në këtë kuptim, para 45 vjetësh, me dy ose tri poezi të veta, qenka zhytur në gabime: nga distanca 45 vjeçare nuk është vështire të jepen mësimë morale. Shpresoj se Matej Bori nuk do të ma zërë për të madhe për këto vërejtje; me tragjikën shpirtërore të intelektualëve të gjallë, që dikur i rrëmbeu çasti i egër të papërgatitur, ndjej një bashkevuajtje të thellë. E përmenda Matej Borin vetëm për arsyen se intelektualët, në një mënyrë edhe sot janë në një situatë të ngjashme. Megjithatë durimi i pabesueshëm i shqiptarëve ndaj një shtypjeje kaq të gjatë, më mbush me optimizëm; ky fakt më jep shpresë se ata do të dinë që edhe atëherë, kur të gjitha organet shtetërore jugosllave do t'uua pranojnë ato të drejta kombëtare që u takojnë edhe sipas konventave ndërkombëtare edhe sipas të drejtës së natyrshme, të heqin dorë në mënyrë dinjtoze nga dhuna dhe hakmarrja ndaj shtypësve të sotëm. (Fund)

Nga slovenishtja: B. Elshani
S. Kabashi

DËBIMI I PAPËRSHTATSHMËRISË

("Vetëm për primitivët historia nis nga dita kur ata kanë lindur"- MARKSI)

Deri tash, në Kosovë, u janë ndërruar emrat disa shkollave të pagëzuara me emra të personaliteteve kulturore dhe historike të popullit shqiptar me pretekst të "stabilizimit të situatës politike dhe të sigurisë"?....

Nën moton e luftimit të nacionalizmit dhe të separatizmit shqiptar vitet e fundit, jo vetëm në Kosovë, janë ndërmarrë e po ndërmerrën disa masa aq të pakuptueshme me të cilat më askush s'po bindet se është fjala për luftimin e nacionalizmit dhe pasojave të tij. Gjërat tashmë janë aq të kristalizuara, saqë, as indiferentët dhe laikët nuk janë më ata që ishin. Në këtë drejtim hyjnë kërkesat e shpeshtuara për ndërrimin e emrave të shkollave dhe institucioneve të tjera që mbajnë emrat e personaliteteve të shquara të historisë, kulturës dhe traditës së popullit shqiptar, sikurse janë Hasan Prishtina, Bajram Curri, Luigj Gurakuqi, Isa Boletini, Azem Bejta, Shote Galica, vëllezërit Frashëri e madje është kërkuar dhe është arritur qëllimi t'i hiqet emri Halit Ibishit, emrin e të cilit e mbante shkolla filllore e Babushit të Serbëve të Ferizajt, i cili për liri u dogj në krematoriumet naziste. Në vazhdën e kësaj fushate i është ndërruar emri i shkollës filllore "Vëllezërit Frashëri" të Miradisë së Epërme të Prishtinës, shkollës së mesme "Luigj Gurakuqi" të Klinës mu në vitin jubilar kur të gjithë, nxënës e mësimdhënës, përgatiteshin të kremonin 20 vjetorin e themelimit të kësaj vatre shkollore. Pastaj është ndërruar emri i shkollës filllore "Azem Bejta" të Grabanicës së Klinës, shkollës së mesme "Skënderbeu" të Preshevës (RSS), etj. Ka kërkesa për ndërrimin e emrave të rrugëve sikurse është rasti me kërkesën për ndërrimin e emrit të rrugës "Shtjefën Gjeçovi" të Lipjanit, etj.

Për ndërrimin e emrave të shkollave me emra të këtyre personaliteteve janë trilluar lloj-lloj shpifjesh dhe janë bërë njollosje të pashembullta të këtyre figurave të ndritura të popullit tonë. Për Isa Boletinin, Hasan Prishtinën, Bajram Curri, etj., si "argument kryesor" mirret kundërshtimi i tyre i hapët depërtimit të ushtrisë serbe pas viti 1912 në Kosovë, e cila, si për popullin shqiptar ashtu edhe për popullin maqedonas, nuk ka pasur karakter çlirimtar, siç mendon historiografia serbe. Për Luigj Gurakuqin, vëllezërit Frashëri etj., kërkohet ndihma e "argumentit" tjetër se këta nuk janë nga vendi ynë? Shkohet edhe

më tej duke thënë se janë përpjekur për "Shqipërinë e Madhe" me qëllim që tu mvishet karakteri "irredentist", domethënë që aktiviteti i tyre i atëherëshëm të shpallet i dëmshëm për të sotshmën.

Për realizimin e synimeve të tilla kanë ekzistuar skenarët e parapërgatitur, kështuqë nxënësit serbë dhe malazias vetëm janë futur në vorbullën e këtyre intrigave, në mënyrë që të krijohet bindja se kërkosat e tilla janë krejtësisht të rastësishme e spontane. Pas insinuatave të tilla nxënësit dhe prindërit e tyre ishin "këmbëngulës" dhe me presione e trike psikologjike të përgatitur deri në përpikmëri ia arrinin qëllimit të tyre aq më parë kur e njihnin terrenin... Fushata për ndërrimin e emrave të shkollave me emra të këtyre personaliteteve ke për synim, si një segment i rëndësishëm programor, dalëngadalë, të realizojë qëllimet e ithtarëve të dealbanizimit të Kosovës, të cilët këtë trevë nuk e shohin ndryshe pos si "zemër të Serbisë", prandaj shpirtëngushtësia dhe primitivizmi i tillë nuk do as të dëgjoje për jetën e të tjerëve në këto hapësira.

Përkundër faktit se kërkosat e tilla, t'i quajmë të "nxënësve dhe prindërve serbë dhe malazias", kundërshtoheshin nga nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit shqiptarë, këta emra, në mënyrë të njëanshme ndërroheshin dhe ata madje as që pyeteshin pos që ndonjë këmbëngulës i cili s'pajtohej me një fushatë të tillë mund të binte, siç është bërë zakon të thuhet me fjalorin denounces, në "sy të keq", sepse gjoja qenka kundër qëndrimeve... Cilave? Të LKJ-së thuhet?!

Komiteti Krahinor i Arsimit të Kosovës, anipse e ka ditur gjendjen faktike, anipse ka qenë në dijeni se emërtimi i shkollave as përafërsisht nuk është në harmoni dhe nuk i përgjigjet strukturës së banorëve të Kosovës, sikur të mos shihte e dëgjonte formoi listën me "emra kontestues" dhe ua dërgoi për të dhënë mendimin për të (para se të merrte qëndrim Kryesia e KK të Arsimit të Kosovës) Institutit të Historisë së Kosovës, ku nuk përcaktohen qartë as "për" as "kundër" dhe Institutit të Historisë së Serbisë në Beograd ku, pa një pa dy, të gjitha këto personalitetë i shpallën persona non grata, "irredentistë, separatistë, shqiptaromëdhenj" e ofendime të tjera nga arsenali i atyre që nuk heqin dorë nga mania për t'ua shkruar historinë të tjerëve!

Kryesia e Komitetit Krahinor, pas "vizës" se "bën t'u ndryshohen emrat këtyre shkollave..." tash s'ka punë tjetër pos që në ndonjë mbledhje të ardhshme të miratojë kërkosën e vet. Situatën në këtë drejtim po e ndërlikojnë ata të cilët fare lehtë, sikurse t'ishte fjala për ndonjë çikërrimë, deklarohen se "do të ndërrohen vetëm emrat ku kërkosat janë të arsyeshme"?! Thuase kërkosat e tilla ishin të arsyeshme?....

Gjendja në Kosovë sot kur luhen lojëra të rrezikshme në terren të zbrazët, të kujton synimet e Mirko Tepavcit për Kosovën "si djep të Serbisë" ku, sipas kësaj logjike shovene, e vetmja alternativë për shqiptarët është që të ndjehen "si qiraxhij në shtetin kombëtar serb, që të binden se janë qytetarë të rendit të dytë, të kuptojnë se vetëm me kusht të njohjes së majorizimit serb mund të qëndrojnë në vendin ku janë, në rajonet në të cilat sot jetojnë". Përkundër faktit të ditur se pikërisht ky synim

tentohet të arrihet, shqiptarët, pos ca shpirtëargatëve, nuk pranojnë e as që pajtohen të jenë qytetarë të rendit të dytë, nuk pranojnë të poshtërohen në vendin e vet sepse e dijnë fare mirë se nuk jetojnë në "tokë të huaj" siç tentohet t'u ngulitet në kokë. Nuk dëshirojnë asgjë tjeter pos barazi të mirëfilltë dhe jetë të getë së bashku me të gjithë të tjerët në këto hapësira të përbashkëta jetësore.

Nxënësit shqiptarë e zhvillojnë mësimin në shumë shkolla kosovare të pagëzuara me emra të madhorëve të kulturës dhe traditës serbe dhe askujt deri tash, fatmirësisht, nuk i shkoi mendja të shpreh as mospajtimin më të vogël. Kjo është shenjë që flet për pjekuri nationale politike. Marksit thotë: "Vetëm për primitivët historia nis nga dita kur ata kanë lindur".

Edhe diçka si porosi për ata të cilët thonë se "LKJ do të reagojë në rastet kur shkilet barazia kombëtare"? S'kanë ç'të presin më dhe nuk është mirë që programin e LKJ e kuptojnë si diçka hyjnore, të mirat e të cilat pritet të pikun nga qielli. Ata vet, si njerëz të gjallë, janë të thirrur ta zbatojnë programin e LKJ-së. Nëse nuk përpilen, atëherë s'mbetet rrugë tjeter pos që ky "program" i "LKJ-së" problemet t'i zgjidh siç dëshirojnë memorandumistët!

E dëshira e memorandumistëve është që çdo gjë ta mbulojnë me programin e LKJ-së e të punojnë praktikisht kundër tij; don të thotë në mënyrë jocivilizuese. Nga kjo mënyrë, e cila po ashtu këlthet se mbështet në Programin e LKJ-së, as që mund të priten suksese. Kjo është pothuaj e sigurtë!

Bajram KABASHI

STIMULIRANJE NEPISMENOSTI

Na Kosovu se več kot 12.000 dijakov albanske narodnosti, ki so končali osnovno šolo, ne bo moglo vpisati v srednjo šolo. Po drugi strani pa je v šolskem letu 1988/89 osnovno šolo končalo 4.735 dijakov srbske in črnogorske narodnosti, v okviru boja proti izseljevanju pa so za dijake tega učnega jezika odobrili več kot 10.000 učnih mest, torej 6.000 več, kot je bilo potreb...

Zadnja leta se število maturantov albanske narodnosti, ki bi se radi vpisali na prištinsko univerzo, drastično znižuje, prav tako pa se s perfidnimi postopki niža tudi število albanskih dijakov na kosovskih srednjih šolah. Odgovorni se pri svojem opravičevanju sklicujejo na zapleteno politično stanje v pokrajini in na "hrup", ki naj bi ga inscenirali separatisti, vendar ti neprepričljivi odgovori pomenijo zgolj kuliso za doseganje drugih zastavljenih ciljev.

Bodimo bolj konkretni.

To šolsko leto je osemletko končalo 37.080 dijakov albanske, srbske, črnogorske in drugih narodnosti, ali z drugimi besedami, 32.145 dijakov albanske narodnosti, 4.735 dijakov srbske in črnogorske narodnosti ter 200 dijakov turške narodnosti. Kot je zapisano v izobraževalnem programu pokrajinskega SIS, je za šolsko leto 1989/90 za vpis v prvi letnik srednjega izobraževanja načrtovanih 32.693 prostih mest, od katerih bo dijakom albanske narodnosti na voljo 21.000 mest, dijakom srbske in črnogorske narodnosti 11.400 mest in dijakom turške narodnosti 224 mest.

Iz številk tega programa je razvidno, da je dijakom, ki bodo obiskovali pouk v srbohrvaškem jeziku, na voljo 6.665 prostih mest več, kot je kandidatov, dijaki turške narodnosti pa imajo na razpolago 24 mest več, kot je njihovo skupno število.

Veliko ljudi se sprašuje, ali ne doživlja Kosovo - konkretno albanski dijaki - getoizacije na kulturnem in nacionalnem področju, prav tako kot njihovi rojaki v Makedoniji in Črni gori.

Kot je znano, je v Makedoniji srednje šolstvo v albanskem jeziku že popolnoma eliminirano (zdaj delajo eksperimente že tudi z osnovno šolo), vse to pa naj bi bilo v čast razvoju, potrjevanju in poglabljanju bratstva in enotnosti naših narodov in narodnosti. Ta cinični humanizem že žanje svoje prave "uspehe", o tem neusmiljeno priča glasilo mladine Mlad borec, ki v eni svojih številk navaja, da v neki kičevski vasi v osnovni

šoli z albanskimi učenci pouk poteka v makedonščini. Mlad borec gre še naprej v svojih nekulturnih in nepoštenih ugotovitvah, češ da se je pri albanskih dijakih in njihovih starših končno trdno uveljavilo prepričanje, da so "makedonski Šiptarji".

Takšna nacionalna podrejenost Albancev gotovo ni plod "velikih civilizacijskih dosežkov albanske narodnosti v Jugoslaviji" (fraza, ki je ne ponavlja na pamet samo pokrajinski politiki), prisotna pa je tudi v Črni gori, v krajih, kjer živi albanska narodnost. Kot zgled naj navedemo primer iz občine Bar, konkretno iz vasi Murič, kjer naj bi se albanski dijaki, tako vsaj je obveščena javnost, "prostovoljno" odrekli svojemu materinemu, brezperspektivnemu albanskemu jeziku. Ta zgled, ki naj bi "prispeval k sožitju bratstva in enotnosti", so pozdravili tudi vodilni izobraženci iz Bara (o tem je pisal časnik Politika).

Primerjava teh diskriminatorskih in asimilacijskih teženj, ki so na delu v Makedoniji in Črni gori, z 12.000 dijaki albanske narodnosti na Kosovu, ki nimajo prvice do vpisa v srednje šole, ni naključna, temveč namerna, kajti ti mračni načrti so v našem balkanskem okolju postopno, a zanesljivo otipavanje "utripa".

Še en podatek: na vseh fakultetah pokrajinske univerze na območju pokrajine je načrtovan vpis 49% srednješolcev albanske in 78% srbske in črnogorske narodnosti. Ob tem se zastavlja še bolj mučno vprašanje: kam in na koga naj se obrnejo albanski srednješolci, ki so končali srednjo šolo v Makedoniji in Črni gori?

Na koncu je treba povedati še tole. Na Kosovu nikomur ne pride na misel, da bi v šolskih klopeh zmanjkalo prostora za enega samega samcatega srbskega ali črnogorskega dijaka, vendar pa je treba imeti posluh, in ne samo to, treba si je z vsemi močmi prizadevati, da se noben etnos v pokrajini ne bi počutil prikrajšanega v kateremkoli pogledu. Z drugimi besedami, oženja in jemanja pravice vpisa 12.000 dijakom albanske narodnosti v trenutku, ko je v pokrajini več kot 200.000 prebivalcev nepismenih ali polpismenih, nikakor ni mogoče razumeti drugače, kot da gre za odkrito stimuliranje nepismenosti, ki pomeni največje možno zlo za prihodnost SAP Kosovo.

Bajram KABASHI

MARSHI I BARABAJT

Ishë tejet prekëse përgjigja e pikëlluar që i dha pashai i Vilajetit të Kosovës një gazetari të huaj kur ai e pyeti se përse nuk e do populli i vet. "S'është e vërtetë! - u përgjigj ai i befasuar-përse të mos më dojë!". Dhe vërtetë, përse të mos e dojë populli atë? I shëmtuar nuk është. Fytyra e tij me mustaqet staliniane, me vetullat pinoçetiane, me faqet musoliniane, me ballin allafranga dhe me tenin somoze-dyvalje duket mjaft simpatike. "Mladina" e pamëshirshme na e sqaroi këtë gjë fare bukur me vërejtjen se "megjithatë populli e do, po për ketë nuk është i vetëdijshëm". Me siguri një ditë kur t'i shfaqet vetëdija, do t'i dalë në rrugë dhe do t'ia recitojë një deklaratë dashurie. Mirëpo sa po morem vesh se puna ka ecur për mbarë më shpejt se sa kujtojmë. Ca mblesë të panjohur i paskan lënë para derës pashait një peshqesh-çefin. Pritet të marrë edhe peshqeshim martesor-tabutin.

Për të provuar në ishin të vërteta shpifjet mbi mungesën e dashurisë në mes të popullit dhe pashait, xhezdisëm rrugëve të Prishtinës dhe bëmë një anketë. I pyetëm kalimtarët:

Ne: Thonë se nuk e doni edhe aq pashain e vilajetit. Është e vërtetë kjo gjë?

Ata: Aspak. Ne e duam pa masë atë. E ndjekim tërë natën e tërë ditën për ta zënë e për ta puthur, po nuk e zëmë dot.

Ne: Si duket dashuria s'është e ndërsjellë

Ata: Kemi frikë se jo kemi dëgjuar se kohën më të madhe e kalon nëpër garnizone ushtarake. Si duket është dashuruar në armatën. Po ne nuk e kemi humbur akoma shpresën. Posa ta takojmë ndonjë ditë në rrugë, do t'ia numrojmë të gjitha.

Sidoqoftë, dashuria e popullit ndaj tij mund të ketë njëfarë baze logjike, sidomos me zhbirimet psikanalitika të Frojdit e të Lakanit. Ajo mund të shpjegohet edhe sipas shembullit të Markiz dë Sadit, i cili sa më shumë i mundonte femrat, aq më shumë e donin ato. Edhe populli ynë ka një shprehje të qartë në lidhje me këtë çështje. Ai thotë:(te na falin delikatët!) "Pa ia q. nënë dikujt nuk të thërrret babë". Pra ekzistojnë të gjitha rrethanat që populli ta dojë e ta thërrasë baba pashain. Mu si në origjinën e fisit e të shoqërisë tek Frojdi.

Në veprën e Orvelit "1984" kryepersonazhi Uinstoni dashurohet seriozisht në torturuesin e tij O Brajenin. Natyrishët dashuria e tij është sidomos e theksuar në çastet kur O Brajeni i lodhur nga torturat, ulet për të pushuar. Pra shanset janë të mëdha edhe për pashain tonë. Qëkurse i ka lënë punët e

brendshme, ai jo vetëm që është ulur të pushojë, po madje edhe i premtoi popullit amnesti. Natyrisht, ngaqë është i turpshëm, këtë premtim nuk ia dha, por vajti në një republikë tjeter. Përse nuk u realizua ky premtim? Ndoshta për inat të gjitha organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat gjithashtu kërkojnë lirimin e të burgosurve politikë në Absurdistan. Apo ndoshta se një gjë e tillë nuk varet prej pashait. Sidoqoftë, mjafton që ai ka qëllime fisnike ndaj popullit. Sapo t'i japë shenjë i zoti, ai është gati të bëjë çmos për të.

Në realitet, aspektet e tillë të dashurive të jashtëzakonshme janë mjaft të shpeshta. Ato shpesh na shfaqen edhe në format më ekstreme:

-Miu dashurohet në maçokun!

-Pula dashurohet në dhelprën!

-Qingji dashurohet në ujkun!

Për të gjitha këto raste populli ynë ka një shprehje interesante, ai thotë se është fjala për-pirin. Pra është piri i ujkut, i dhelprës e i maçokut ai që luan rol vendimtar në pervetësimin e viktimave, në nxitjen e nostal gjisë përmes vështrimit plot dashuri misterioze. Një dashuri të tillë të jashtëzakonshme na e përshkruan në tregimin e tij të mençur (ose të marrë: merre si të duash!) "Asja dhe ujku" "miku" i madh i popullit tonë, ministri mbretëror i devotshëm, Ivo Andriq. Në këtë tregim një ujk mbetet pa mend nga loja e mrekullueshme e qingjit. I merr flakë pasioni artistik dhe i zhduket uria fiziologjike. I lind dashuria dhe i dhimbset ta hajë. Dhe ujku i civilizuar pa ndërruar qimen fare, e ndërron hujin*. Ja një zbulim fantastik. Ja një ide shpëtimtare edhe për popullin shqiptar në Absurdistan: të ushtrojë pak balet dhe vallezim dhe pastaj të shkojë kolektivisht në Bizantion, në "ngushticën" e njohur midis dy lumenjve. Aty të fillojë një valle kolektive. Ujqërit do të zbuten e nuk do t'i hanë më. Nuk do të angullijnë më netëve nëpër hënë ujqëri si Drashkoviqi e Komneniqi. Vetëm një gjë nuk është e qartë: ç'valle do të duhej të lozni ata për të kënaqur shijet e kryeqytetit? S'u mbetet gjë tjetër pos të thërrasin në ndihmë muslimankën (në mos qoftë kunguar akoma) Fahreta, që me këngët dhe vallet e saja e ka topitur fare teuhun antimusliman të kryeqytetit duke u dhënë shembull gjithë muslimanëve të vendit se si duhet të sillen për ta kthyer urrejtjen e të tjerëve në dashuri.

Përndryshe çështja e muzikës nuk është edhe aq e parëndësishme. Filozofi i moçëm kinez Konfuçi në traktatin e tij mbi muzikën thotë madje se ajo ka rëndësi të dorës së parë për mbarëvajtjen e punëve të shtetit. Pushteti maqedon, kur bëri reduktimin e njohur të muzikës shqiptare në valët e Radio Shkupit, si duket i kishte parasysh pikërisht idetë e konfuçianizmit. Edhe në Kosovë me muzikën s'është mahi: vetëm përkëndimin e këngës më të këndshme për veshët: "N'Dardani bie një tupan"**që prej 4-5 viteve të shkuara janë dënuar me dhjetëra amatorë të muzikës. Në psikologji gjendet një shprehje që e përcaktón qartë defektin shqisor të atyre që s'kanë veshë përmuzikë por vetëm për urdhëra e direktiva,- i thonë amuzi. Si duket gjykatesit tanë vuajnë nga një amuzi totale

senzorike-motorike. Sa për vete do ta këndoja atë këngë që më pëlqen, mbështetur në proverbin e njohur se kush këndon, keq s'mendon. Do ta këndoja me këtë rast për veshët e pashait tone dhe për gjithë larot e tjere të sulltanit, si dhe për ata vetë, një këngë alternative për dashurinë e popullit ndaj diktatorit, të një kompozitor i dëshiruar politikani alternativ shqiptar, "Marxin e Barabbajt" të Fan Nolit. Për orkestër nuk do të zgjedh as rokun e zhurmshëm dhe as një mal instrumentesh të ndonje filharmonie, por vetëm atë që e përdorin telallët, dasmorët dhe lajmëtarët e iftarit, tupanin buçites:

Rrum-dum, dum, rrum-dum,

Allalla, o rezil e katil, allalla,
Shtroni udhën me hithr' e me shtok turfanda,
Gumëzhit, o zingjir e kamçik, baterma,
Lejni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

Tradhetor, ti na nxive, na le pa atdhe,
Ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fe,
Varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe,
Derbeder, ujk e derr: Hosanna, Barabba!

O stërnip i Kainit, tepdil si bari,
Ti na shtyp e na shtryth e ti gjakun na pi,
Ti na ther e na grin e për qejf na bën fli;
O kokuth e lubi: Hosanna, Barabba!

O i çgryer, i zhyer, i vyer për hu,
Turp-e-nidot-kundermonjës të krusen mbi gju
Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,
Zemër-krund-e-gerdhë: Hosanna, Barabba!

Në bodrum, nëpër llom' e kufom' u-mallkofsh,
Në skëterrën, katran e tiran, u-harbofsh,
Me tam-tam e allarm'e me nem' u-shurdhofsh,
Në zindan mbretërofsh: Hossana, Barabba!

Mos e dhashtë zoti që miqtë tanë, sheh-ul-islami dhe myteselimët të vuajnë edhe ata nga ndonjë amuzi ase apoezi kronike, sepse mund të na ndalojnë edhe këtë këngë, dhe atëherë s'na mbetet tjetër pos tjetër pos të çelim një vrimë në dhee të bërtasim: "Mbreti Trajan ka vesh të dhisë!" Sidoqoftë, lavdi të përjetshme autorit, sepse askush s'e shau aq bukur despotizmin si ai, as Lorka Frankon dhe as Neruda Pinoçetin. Prandaj edhe një herë:

Allalla, o rezil e katil, allalla,
Shtroni udhën me hithr' e me shtok turfanad,
Gumëzhit, o zingjir e kamçik, baterma,
Lejni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

Rrum-dum, dum, rrum-dum, rrum-dum,

-dum-

Shënimë:* Ngjarjen e këtij trëgimi disa kritikë e çmojnë si një fenomen real jetësor, si shprehje të fuqisë së artit për qërimin

e qenies njerëzore nga vetitë e egra, primitive shtazarake, dmth. për qytetërimin e tij. Natyrisht, si ky tregim i Andriqit, ashtu edhe ai me titull "Ruga e Gjergj Elez Alisë" janë ndërtuar në bazë të dy inverzioneve të dështuara, me ndikim të theksuar të psikologjisë idealiste-subjektiviste të Frojdit. "Asja dhe ujku" është inverzion i fjalës së urtë populllore "Ujku qimen ndërron kurse hujin jo", ndërsa tregimi i dytë është inverzion i këngës kreshnike për heroin më trgjik të fantazisë populllore shqiptare, të ngritur në shkallë të simbolit kombëtar-Gjergj Elez Alisë. Ivo Andriqi, mbasë me qëllim për ta fyter një popull të tërë, e kthen këtë hero në një lolo, një satir të pangopur komik që u vardiset pa sukses femrave. Si duket, Andriqi-artist ishte po aq i ulët moralisht sa Andriqi-politikan.

**Siç mund ta marrim me mend, prapavinë irredentiste të kësaj kënge jurisprudencia imbecile e Kosovës e sheh në titullin e saj, sipas saj, territorialist pretenduese (Dardania ilire përfshinte përafërsisht tokat e sotme të Kosovës e të një pjese të Maqedonisë) duke mos marrë parasysh se sot nuk gjindet ndonjë territor në Gadishullin Ballkanik me emrin Dardani, dhe se Dardania, në të cilën bie tupani i këngës, në të vërtetë nuk është asgjë tjeter pos emri i Pallatit të Kulturës në Qytetin Bajram Curri dhe se nuk ka asgjë më të natyrshme se sa kumbimi i tupanit në një pallat kulture.

Tanush TORBARI
DARDANI

LUBO BAVCON:

PËR KË BIE KAMBANA

PROCESI KUNDËR AZEM VLLASIT ME TË BASHKAKUZUARIT ËSHTË NJË PROCES POLITIK, ËSHTË NJË DEGRADIM I SHTETIT JURIDIK, ËSHTË NJË TURP PËR JUGOSLLAVINË

Këto ditë patëm rastin të lexojmë në shtypin ditor pjesën dispozitive të aktakuzës kundër Azem Vllasit dhe katërmbydhjetë të akuzuarve të tjerë, në mesin e tyre disa ish-funksionarë të lartë shtetërorë, politikë dhe ekonomikë të KSA të Kosovës. Pjesa e publikuar e aktakuzës 99 faqëshe zbulon me një qartësi të plotë esencën politike, kuptimin politik si dhe qëllimet e fundit të kësaj procedure penale që pati filluar shumë muaj më parë me paralajmërimin e arrestimeve të të akuzuarve dhe e cila, sipas paralajmërimeve të tanishme të prokurorit publik të qarkut të Mitrovicës së Titos, do të përfundojë me shqyrtimin kryesor pas nja dy muajsh.

Pjesët thelbësore të aktakuzës janë publikuar në shtypin ditor ndërsa prokurori publik Zamfiroviq, me rastin e ngritjes së aktakuzës organizoi madje edhe një konferencë shtypi. Kështu kjo aktakuze u bë pronë e opinionit publik, dhe në këtë aspekt nuk ka mbetur për t'u pandehur me asgjë, që përndryshe do të nënkuptohej sipas parimit të gjyqësisë së pavarur. Gjykimi i pavarur në këtë rast, në RS të Serbisë u përjashtua qysh prej deklarimit të S. Milosheviqit në tubimin demonstrativ para Kuvendit Federativ, se fajtorët për ngjarjet në Kosovë do të jenë "të dënuar dhe të arrestuar", pastaj me konferencën e shtypit të prokurorit publik, me publikimin e pjesëve të aktakuzës dhe me komentimet e shtypit serb, që ne kundershtim me parimin e pafajësisë potenciale, e trumbetojnë qysh tanë me triumf veprimtarinë kriminale të të pandehurve. (POLITIKA, 30. 6. 1989, fq. 10)

Në këto rrethana nuk shohim ndonjë pengesë për një analizë të hollësishme juridiko-profesionale dhe juridiko-politike të kësaj aktakuze dhe të procesit në tërësi. Më vonë, ndoshta, këtë gjë edhe do ta bëj, së paku për shkaqe pedagogjike, dmth. që studentët e drejtësisë të shohin konkretisht se çfarë s'do të duhej të ndodhte në një shtet evropian 200 vjet pas Revolucionit Francez, dhe pas Deklaratës mbi të Drejtat e Njeriut. Hë për hë do të na mjaftojë analiza e pjesëve të aktakuzës të shpallura para opinionit, përveç tjerash nënkupton edhe protestën time të hidhur njerëzore dhe profesionale kundër edhe një procesi politik, në vargun e shumë proceseve të tjera që janë në vazhdim, (sepse ky, përndryshe, nuk është i vetmi). Është kjo një protestë kundër keqpërdorimit arrogant të së drejtës penale dhe jurisprudencës për qëllime politike dhe qërimë të ndryshme të hesapeve që u përkasin fakteve më të errëta të modelit stalinist të socializmit në historinë tonë dhe të huajën më të afërt. Prandaj ringjallja e proceseve ndëshkimore politike, sidomos me përmasat çfarë i përban procesi kundër A. Vllasit, është një shfaqje kërcënuese, ngjethëse, që na tregon se në një pjesë të Jugosllavisë është ngjallur gjithashtu një regjim politik

ideologjik i vendosur me dhunë, të cilin rëndom e përcaktojmë totalitarizëm, stalinizëm e të tjera të ngjashme.

Procesi kundër A. Villasit dhe të akuzuarve tjerë, bazuar në aktakuzën, i përmban veçoritë tipike të proceseve politike. Për këtë dëshmojnë dhe këtë pohim e vërtetojnë faktet e mëposhtme:

1. Aktakuza është formuluar mbi bazë të hipotezës tashmë të njohur të udhëheqjes së tanishme të RS të Serbisë, hipotezë përkundërrevolucionin në Kosovë. Është kjo një hipotezë e diskutueshme, të cilën e hedhin poshtë me forcën e argumenteve shumë politikanë, sociologë dhe publicistë nga anëtë tjetra të Jugosllavisë, dhe të cilët konfliktin kosovar e vlerësojnë krejtësisht ndryshe. Siç duket, për natyrën e ngjarjeve dhe përgjendjen reale në Kosovë ekzistojnë më shumë se sa "një e vërtetë" dhe me shumë vlerësimë politike, të cilat bëhen shkaktare për ndryshimin e qëndrimeve të veta të shumë grupeve dhe palëve, mirëpo sidoqoftë, nuk bën kurrsesi që kjo çështje të bëhet edhe lëndë e ndonjë procedure penale. Pikërisht sepse të mundurit në konfliktet politike nuk janë kriminelë. Në fillim të shekullite të kaluar lindi nocioni i deliktit politik si një delikt i privilegjuar. Nëqoftëse njëqind e pesëdhjetë vjet më vonë, megjithatë na shfaqet sërisht në formën e tij brutale, atëherë është e qartë se kemi të bëjmë me një keqpërdorim flagrante të së drejtës penale dhe të jurisprudencës me qëllimqë reprezaljet politike kundër atyre që mendojnë ndryshe të duket sikur janë të ligjshme.

2. Kundërshtarëve të pikëpamjeve të udhëheqjes së tanishme politike të RS të Serbisë mbi kundërvolucionin në Kosovë dhe mbi nevojën përzgjedhjen me anë të dhunës së krizës kosovare në nivel të së drejtës penale, nuk mjafton që vetëm t'u ngarkohen qëndrime tjeterfare politike, por është e nevojshme që edhe të kriminalizohen. Këtu e ka burimin hipoteza mbi të ashtuquajturin "Plan të Shtabit" sipas të cilit do t'u zhvilluaka kundërvolucioni në Kosovë. Ky "Plan i Shtabit" qenka përbajtja e njëfarë trakti të cilin e paskan gjetur organet e punëve të brendshme, siç deklaroit në Kuvendin Federativ Lazar Mojsovi, anëtar i Kryesise së atëherëshme të RSFJ, mirëpo është intersant, se kurrëndonjëherë opinionit publik jugosllav, nuk ia treguan atë trakt. Në këtë veprimtari kundërvolucionare (shkëputur nga faqet 5-7 të aktakuzës) drejtua kundër vëllazërim - bashkimit, barazisë së kombeve dhe të kombësive, me qëllim të minimit të bazës ekonomike të vendit gjatë vjeshtës së vitit 1988 dhe në pranverë të vitit 1989 qenka inkuadruar edhe A. Villasi me të bashkëpandehurit, ndërsa një veprimtari e tillë paska pasur si rrjedhim vdekjen e shumë njerëzve dhe paska shkaktuar rrezikimin e shumë jetërave njerëzore, dëme të mëdha si dhe paska kërcënuar sigurinë dhe fuqinë ekonomike të shtetit (shih fjalët e p.l. të nenit 139, të LP të RSFJ).

Veprimet që duhej të dëshmonin inkuadrimin e A. Villasit në veprimtarinë e përmendur kundërvolucionare, si dhe mënyra e inkuadrimit, sipas aktakuzës janë s'vijon:

a) I paska mbushur mendjen një shoku që t'i propozonte organizatës së vet të LK për t'i dërguar një telegram përkrahjeje për të dhe për Kaqusha Jasharin - KQ të LKJ dhe KK të LK të Kosovës. (fq. 7)

b) Paska bërë presion mbi anëtarët e KK të LK të Kosovës që të mos votojnë për shkarkimin e propozuar të Kaqusha Jasharit, si kryetare e Kryesise ë dhe të atij vetë, si anëtar i Kryesise së KK të LK të Kosovës.

c) Se në zyrën e drejtorit të Qendrës së Studentëve në Prishtinë në lidhje me demonstratat e punëtorëve dhe studentëve të kombësise shqiptare, paska deklaruar: "Populli dëshiron të shpreh mendimin e vet dhe disponimin e vet pasi tubimet njënationale tashmë kanë hyrë në modë, atëherë kanë të drejtë edhe ata, si të gjithë popujt tjerë të Jugosllavisë, ta shprehin mendimin e vet". Me këtë i paska nxitur studentët që t'u bashkohen demonstratave të ounëtorëve që po zhvilloheshin atë ditë (fq.8)

ç) Se i paska drejtuar me dorë punëtorët e ardhur në Prishtinë nga ana e Gjilanit, edhepse më parë Kaqusha Jashari paska provuar t'i kthejë prapë në Gjilan, veprim të cilin i paska siguruar demonstratave punëtore masivitet më të madh. (fq.8)

d) Se në fjalimet e veta para pjesëmarrësve në demonstrata në stadiumin e futbollit dhe në palestrën e sporteve në Prishtinë paska shfaqur qëndrime demagogjike dhe lideriste, me të cilat paska krijuar bazën për një rezistencë kundër përtrirjes kadrorike në Kosovë dhe paska penguar kryerjen e procedurës demokratike dhe të përcaktuar me Kushtetutë për ndryshimin e Kushtetutës së RS të Serbisë, (fq.8-9) prandaj për këtë qëllim, thotë aktakuza në fq. 9. në mes tjerash paska thënë: "Ajo që siguron unitetin e Jugosllavisë, barazinë dhe lirinë e të gjitha kombeve dhe të kombësive, është vendosmëria e njerëzve për të mbrojtur Kushtetutën e vitit 1974."

e) Se në natën midis 24 e 25 shkurtit 1989 i paska vizituar fshehurazi minatorët grevistë të minierës së Stari Tërgut me qëllim që t'i inkurajojë në vendimin për të qëndruar fuqimisht pas kërkesave të tyre kundërrevolucionare, sidomos në detyrimin e dorëheqjeve të Rrahman Morinës, Husamedin Azemit dhe të Ali Shukriut. (fq.10-11)

Për nga përbajtja, kuptimi dhe pesha janë të ngjashme edhe "veprimet" që u ngarkon aktakuza edhe tre të akuzuarve të tjerë kryesorë, ndërsa të akuzuarve prej nr. 5 deri 15 aktakuza u cakton role të dorës së dytë, më pak të rëndësishme. Në shikim të parë është e qartë se kjo aktakuzë i kriminalizon sjelljet më të rëndomta dhe më të përditshme njerëzore, pikëpamjet dhe deklaratat e njerëzve që janë pjesëmarrës në jetën politike të ndonjë partie. Lidhja e komunistëve, natyrisht mundet që në pajtim me statutin e saj të përjashtojë nga udhëheqja partiake, madje edhe nga anëtarësia, ndonjë anëtarë të sajin, që ka qëndrime tjerafare ose që nuk respekton disciplinën partiake, ndonëse është ngapak e diskutueshme çështja se a mundet ndonjë parti demokratike t'i lejojë vetes të ndërmarrë masa per përjashtim apo sankcione tjera kundër një anëtari që, fjalabie, nuk është i pajimit me ndryshimet e caktuara kadrorike në partinë e tij. Mirëpo një gjë e tillë nuk mund të ketë kurrëfarë rëndësie për të drejtën penale ose për jurisprudencën, përveç nëse nuk duan të identifikohen partia politike në pushtet dhe organet shtetërore me ato të jurisprudencës. Bazuar në faktet që dalin nga aktakuza, në RS të Serbisë, edhe tridhjetë vjet të

plota pas Kongresit VII të LKJ më 1958, është gjithnjë në fuqi identifikimi i shtetit me partinë. Këtë fakt, natyrisht duhet trajtuar si një cënim të programit të LKJ dhe të qëndrimeve të saja të shpallura shumë herë më vonë dhe para së gjithash, si një keqpërdorim të palejueshëm të së drejtës penale dhe jurisprudencës për qërimin e hesapeve politike në LK të Serbisë.

3. Inskenimin e procesit kundër Villasit dhe të bashkakuzuarve e mundëson përveç fuqisë monopoliste politike të udhëheqjes në RS të Serbisë, gjithashtu edhe përbajtja e një nenit aq shumë të kritikuar, nenit 114 të LP të RSFJ (Rrezikimi kundërrevolucionar i rendit shoqëror). Në këtë nen përdorimi i një togu fjalësh si: "Kush merret me veprime që çojnë kah shkatërrimi...minimi...rrëzimin...përbysjen..." etj. Është plotësisht i papercaktuar, prandaj jep mundësi për kriminalizimin e gjithçkafit, pa asnjë kufi, sipas tekave dhe dëshirave të regjisoreve të proceseve politike. Prandaj vitin e kaluar, unë së bashku me prof. Pavçnikun, i bëmë një propozim Gjyqit Kushtetues të Jugosllavisë që të shqyrtojë harmonizimin e këtij neni me parimin e ligjëshmërisë që është njëri nga parimet kryesore të Kushtetutës ne fuqi. Gjyqi kushtetues jugosllav sugjerimin tonë e refuzoi menjëherë me arsyetimin se një kundërthënie e tillë nuk ekzistuaka! Se një qëndrim i tillë i Gjyqit Kushtetues të Jugosllavisë paraqet një diletantizëm juridik dhe një njëanshmëri politike vërtetojnë qartë edhe theksimet themelore të aktakuzës në shqyrtim, paraqitur shkurtimisht më sipër. Prandaj shi tani është akoma më e nevojshme që të hiqet ajo dispozitë, ose së paku, që të ndryshohet në formën korrekte-profesionale, sepse tashmë është e qartë rrezikshmëria e saj e rëndë ndaj sigurisë juridike të qytetarëve. Pas heqjes, gjegjësisht ndryshimit të tij, është e sigurtë se nuk do të ketë më mundësi, ose së paku, do të jetë shumë më vështirë për të organizuar shfaqje të proceseve të tillë ose të ngjashme politike. Kjo gjë na e thot shkoqur se përsë edhe sot e kësaj dite disa faktorë nga prapaskena, me aq këmbëngulje i pengojnë ndryshimet e nevojshme në LP të RSFJ, në kreun e veprimeve të dëmshme kundër shtetit, sidomos të neneve 114, 133 dhe të disa neneve të tjera, edhepse ndryshimin e nenit 133 e ka kërkuar madje edhe vetë Kryesia e mëparshme e RSFJ.

4. Dispozita e nenit 114 të LP Të RSFJ mbi rrezikimin kundërrevolucionar të rendit shoqëror, përfat të keq është një e drejtë penale në fuqi, edhe kësaj mund t'i referohet cilido që do të dëshironte t'a përdorte dhe që në të njëjtën kohë të thirrej me dyfytërsi në parimin e ligjëshmërisë, mu atëherë kur do të tentonte që me të të mbulonte arbitraritetine e veprimit të vet jolegjitim të dhunës. Sidoqoftë, në kundërshtim me të gjitha këto ekzistojnë gjithashtu edhe rregullat profesionale të së drejtës penale dhe gjykatesit e pavarur politikisht do të duhej t'i merrnin parasysh vërejtjet që për përdorimin e këtij neni qysh para disa vitesh i kanë shkruar madje mu ata profesorë të së drejtës penale që në emër të sigurisë së shtetit tonë dhe rregullimit të tij shoqëror socialist, janë pajtuar, së paku dikur, me një inkriminim kaq të dyshimtë të nenit 114. Qysh në vitin 1978, p.sh. prof. Nikola Serzentiqi shkroi: "Edhepse veprat e kryera në këtë veprimitari të dëmshme nuk janë përcaktuar

konkretisht me ligj, është larg çdo dyshimi se ato duhet të jenë patjetër në lidhje me shkaktimin e rrezikut (për rendin shqëror dhe sigurinë e RSFJ-vër. e autorit. Vlerësimi për të është një bazë ligjore për të konkluduar se akëcili veprim është i drejtuar me rrezikimin e objekteve të sigurisë të theksuara sipas ligjit. Ky vlerësim duhet të bazohet në të vërtetën, në konstatimin objektiv të ekzistencës dhe të lidhjes shkakësore midis veprimit dhe pasojës... Cfarëdo përfytyrimi që do t'ishte jashtë lidhjes reale midis veprimit dhe pasojës së drejtëpërdrejtë të veprimit, fare lehtë mund të na çojë gjer te përdorimi i paligjshëm i sankcioneve ligjore."

Prof. Franjo Baçiçi nga ana e tij shkruan: "Duhet pasur kujdes në marrjen parasysh vetëm të veprimeve, gjegjësisht sjelljeve, që janë pjesë përbërëse të ndonjë plani subverziv me një qëllim të përcaktuar qartë. Kjo gjë kërkon respektimin e parimit të ligjëshmërisë dhe respektimin e kërkeshës që veprimet e kryera të jene shoqërisht të rrezikshme, çfarë do të thotë se duhet të jetë fjala për veprime që vetëm sa paraqesin, mbështetë akoma së largu, po megjithatë, një rrezikim kundërrevolucionar të rregullimit shoqëror."

Edhe një laik i vërtetë në fushë të drejtësisë do të mund të vërente se veprimet e përmendura më sipër, për të cilat aktakuza e rëndon A. Villasin, as përnga natyra as përnga pesha, as pënga kuptimi, nuk paraqesin kurrefarë elementesh të rrezikshmërisë shoqërore, dhe nuk janë kurrësesi në lidhje shkakësore me çfarëdo rrezikimi të rendit shoqëror, aq më pak me pasoja të rënda të parapara me nenin 139 të LP të RSFJ, të cilat akakuza thjeshtë ia var në qafë të akuzuarit, duke përshkruar fjale për fjale përbajtjen e këtij neni, pa ofruar së paku një argument konkret. Shkruesit e kësaj aktakuze gjithsesi janë përpjekur që të na përshkruajnë rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve të inkriminuara, mirëpo për këtë qëllim kanë përdorur një mori fjalësh boshe, frazash ideologjike dhe përfytyrimesh spekulative arbitrale, të cilat bëjnë që tërë aktakuza, në bazë të irelevancës së plotë penalo-juridike, të "fajeve" të numruara të shembet si një kullë prej kartërash. Këtu qëndron arsyesa se përsë në faqet e aktakuzës përsëriten vazhdimisht vlerësimi politike të të gjitha llojeve, dhe qëndrimet partiake përkundërrevolucionin në Kosovë, si të vetmet të vërteta të shenjta, qëndrime që edhe po t'i marrim si fare të drejta, të tëra së bashku nuk do të kishin kurrefarë lidhjesh me sjelljet dhe veprimet e A. Villasit dhe të të akuzuarve të tjerë; edhepse janë veprime që përbëjnë lëndën dhe bërthamën e kësaj aktakuze.

5. Aktakuza përban një veçori interesante dhe perfide që konsiston në faktin se veprimet, sjelljet, deklaratat etj. me të cilat ngarkohen të akuzuarit, në rastet më të shpeshta ndoshta vërtetë edhe i kanë bërë, meqë tekefundit as që janë të ndaluara dhe aq më pak të pamoralshme. Prandaj përpiluesit e kësaj aktakuze kanë qenë të detyruar që të gjitha veprimeve që u ngarkohen të akuzuarve, t'u mveshin rëndësi, kuptime dhe qëllime të veçanta. Është e qartë tashmë, se çdo fjale ose fjali, çdo bisedë me ndonjë person të huaj, çdo vizitë, çdo bisedë telefonike dhe në përgjithësi gjithçka që ndonjëri nga të akuzuarit ka bërë gjatë vjeshtës së vitit 1988 dhe në pranverë të

të '89-tës, ata e kanë rishikuar, e kanë lidhur në dofarë konstruktesh logjike spekulative dhe me kombinacione të ndryshme fantastike. Duke i marreë parasysh këto është e qartë se përse A. Villasi e mbylli gojën dhe e refuzoi çfarëdo bisede të mëtejshme me gjykatesin hetues, apo i deklaroi atij se nga ana e vet është sjellë në pajtim me linjën e LKJ dhe të vendimeve të organeve gjegjëse; se ka zbritur në galeri vetëm atëherë kur ka parë se Stipe Shuvari nuk ua mbushi dot mendjen minatorëve që të dalin nga galeritë, dhe gjithsesi për të provuar edhe vet me angazhimin personal që të bëjë diç që minatorët të dalin prej galerive; dhe se nuk sheh kurrëfare lidhjesh të veprimeve të veta me veprimet e të akuzuarve të tjere (shiko faqet 66-67 të Aktakuzës). Mbrojtja e të akuzuarve në raste të këtilla është shumë më e vështire se sa në rastet kur aktakuza u vë për barrë veprime të vërteta kriminale, por të cilat në të vërtetë ata nuki kanë bërë. Në rastet e tillë para gjyqit rrjedh rëndom ose më drejtë lehtë mund të rrjedh një shqyrtim i vërtetë i fakteve, ndërsa në aktakuzën kundër A. Villasit dhe të bashkakuzuarve ka vetëm theksime të të të akuzuarve për synime, qëllime dhe prapavijë subjektive të veprimeve të inkriminuara. E mira e së mires do t'ishte që gjyqi t'a refuzonte këtë aktakuzë që në fillim, qysht gjatë procesit të marrëveshjes, gjegjësish që të sillte një aktvendim amnestues, ngaqë veprimet e ngarkuara nuk kanë kanë qenë veprime të dënueshme. Diçka e tillë, sidomos në proceset politike, natyrish nuk mund të ndodh kurrë, duke marrë parasysh arrogancën e përbetuar të akuzës, prapavijën dhe qëllimet politike të dala në pah qartë në të, në atmosferën e krijuar nga udhëheqja politike të cilin e fryn edhe më tepër shtypi, faktorë këta që medoemos i shndërrojnë të gjitha, madje edhe gjyqet, në mjete të bindura ose së paku të dëgjueshme, të qendrës komanduese të pushtetit politik.

**

Në bazë të analizës së kësaj aktakuze shihet, pra qartë se është fjala për një proces politik; proceset politike nga ana e tyre janë pjesë përbërëse të pashmangshme dhe produkte logjike të një sistemi politik dhe ideologjik të bazuar në dhunën që pogallon në një pjesë të Jugosllavisë. Njëra nga veçoritë e një sistemi të tillë është pozita prej të një nënshtruari e organeve të represioneve penale ndaj qendrës se forcës së pushtetit politik dhe ideologjik, ku organet e punëve të brendshme, sidomos Shërbimi i Sigurimit Shtetëror e marrin rolin e policisë politike dhe bëhen forca goditëse e qendrës në fjalë politike ideologjike. Për këtë arsyе policia politike fiton autorizime të pakufishme, formale dhe joformale (të fshehta, sekrete) në mënyrë që vetëm po t'i shkelë syrin, po t'i japë urdhër politik, ajo është e gatshme që ta hap procedurën penale kundër kujtdo që paraqet pengesë përklikën udhëheqëse në pushtet. Për shkak të një pozite të këtillë të policisë politike, në realitet vijnë në fuqi raportet e përmbyshura midis organeve të ndryshme të jurisprudencës penale. Të drejtën për të vendosur dhe autoritetin e ka policia politike. Prokuroria publike bëhet ekzekutuese e vendimeve politike në

nivel të së drejtës penale dhe formuluuese e trajtës juridike, ndërsa gjykatave ju mbetet që me ceremonialet e tyre, shpeshherë edhe publike, t'i vërtetojnë vendimet paraprake të udhëheqjes politike për "faktet" dhe "fajtorët" e dënimet.

Reprezaljet politike, përndjekjet dhe hallakatjet policia dhe politika natyrisht mund t'i bënин lehtë madje më lirisht, edhe pa të drejtën penale, mirëpo një gjë e tillë në botën bashkëkohore, sidomos në Evropë, nuk është e mundur të bëhet më. Për këtë shkak regjimet e tillë e vënë në shërbim të "interesave" dhe nevojave të veta edhe të drejtën materiale ndëshkimore në mënyrë që ushtrimit të pakufishëm dhe jolegjitim të dhunës ndaj njerëze t'i jasin pamjen e ligjëshmërisë dhe të drejtësisë. Kësaj i shërbejnë edhe ato dispozita të legjislaturës materiale ndëshkimore që në esencë janë të ngjashme me të gjitha regjimet totalitare dhe të cilat pa kufi dhe pa kurrëfare respektimi të lirive dhe të drejtave të qytetarëve inkriminojnë "trdhëtinë e madhe" gjegjësisht "rrezikimin kundërrevolucionar të rregullimit shoqëror" (neni 114 i LP të RSFJ), propagandën armiqësore (neni 133) bashkimin për veprimtari armiqësore (neni 136) si dhe disaveprime të tjera.

E tërë kjo ka për pasojë degradimin e gjyqeve, institucionë që do të duhej sipas traditës, sipas definimit dhe sipas asaj që presin njerëzit prej tyre, të pavarura, jashtë ose mbi interesat e palëve në kontest, të drejta, të urta, të mençura etj., si dhe kthimin e tyre në "mjete të pagabueshme" (Vishinski) të udhëheqjes politiko-ideologjike për shfarosjen e armiqve klasore dhe te tjerëve dmth. te atyre qëmendojnë ndryshe dhe përfrikësimin e njerëzve në përgjithësi. Nëqoftëse gjykatat e rregullta s'është e mundur të nënshtrohen plotësisht me mjete ideologjike (indoktrinimi, homogenizimi, disciplina partiake etj.) ose me ushtrim të drejtëperdrejtë të dhunës (mes tjerash edhe me inskenimin e proceseve ndëshkimore kundër gjykatësve të pabindur) atëherë regjimet e tillë themelojnë gjyqe të vecanta policore, partiake, ushtarake ose qeveritare për kryerjen e reprezaljeve politike të veshura, sa për dukje, me petkun juridik.

Këtu e kanë burimin pastaj: të hequrit dorë nga parimet themelore të së drejtës penale materiale (parimi i përcaktimit të veprimeve brenda ligit-lex lettra-, koncepti materialo-formal, objektivo-subjektiv i veprimit të dënueshëm, parimi i përgjegjësisë sipas fajit) dhe sidomos shkelja e parimeve themelore të së drejtës procedurale-penale, para së gjithash, të të gjitha atyre që nënkuptojnë garancën për të akuzuarin dhe të drejtën e tij për t'u mbrojtur.

Në këtë mënyrë krijohen të gjitha kushtet për regjizurë dhe inskenim të suksesshëm të proceseve politike, veçori tipike të të cilave janë hipotezat politike paraprake për armiqtë, përkundërrevolucionin, për shkatrrimin, rrëzimin, përmbysjen, minimin etj. të këtyre ose atyre "vlerave" ideologjike. Kuptimet dhe qëllimet e proceseve të tillë në esencë janë të njëjtë: shfarosja e çfarëdo opozite-qoftë ajo reale ose e pandehur-, lufta për pushtet me mënjanimin e rivalëve, dhe të ngjashme. Metodat, ndërkaq, ndryshojnë sipas konstrukcioneve fantastike të akuzës sic janë: kriminalizimi i veprimeve dhe

sjelljeve më të rëndomta njerëzore, i qëndrimeve politike ose deklaratave, imputimet, keqpërdorimi i ndonjë "faji" nga e kaluara, provokimet e llojillogjashme, falsifikimi i dokumenteve rëndues dhe të ngjashme. Është e qartë se në proceset politike, si rregull, nuk mund të shpallen aktgjykime liruese, përvëç në rastet e jashtëzakonshme kur gjyqi është i detyruar të gjykojë edhe ndonjë provokator të policisë, ose edhe "kryedëshmitarin" e akuzës. Për këtë shkak në proceset e tillë s'kane ndonjë rëndësi të vërtetat materiale ose faktet materiale. Rolin vendimtar e kanë "pranimet" e të pandehurve" dhe "rrëfimet e dëshmitarëve" të përpunuar paraprakisht (të frikësuar, të paguar, të kërcnuar, moralisht të degraduar etj.). Për t'i nxjerrë pranimet prej të akuzuarve gjegjesisht për t'i detyruar ata të tregojnë se çfare tregojnë prej tyre, për të vërtetuar kështu vërtetësinë e konstrukcioneve të akuzës, lejohen të gjitha mjetet, gjer edhe përdorimi i torturave, i dhunës fizike ose psiqike, me mjete ndihmëse më shumë ose më pak moderne, me narkotikë edhe me marifete psikologjike të palejueshme nga etika profesionale juridike. Këto janë ndërkaq trajtat ekstreme të barbarizmit të inkvizicionit mesjetar të bartura në kohën tonë.

**

Udhëheqja politike e RS të Serbisë procesin politik ndëshkimor kundër A. Vllasit po e përgatit për arsyen se me të dëshiron të vërtetojë hipotezen e vet politike përkundërrevolucionin në Kosovë, për "shtabin" si dhe "planin operativ" të shtabit të këtij kundërrevolucioni. Ajo dëshiron të përmblush kështu premtimin e S. Milosheviqit dhënë para turmave të egërsuara në demonstratat njënacionale në Beograd kur tha se "fajtorët për gjendjen në Kosovë do të dënohen dhe do të arrestohen" si dhe për shkak se duan që me represion politike, politike dhe poliore të shtypin çdo rezistencë dhe çdo mospajtim kundër pikëpamjes së tyre për pozitën e popullit shqiptar në Jugosllavi.

Ky proces politik nuk mund të ketë zgjidhje të drejtë me rrugë legitime, ligjore, me drejtësi dhe korrektësi profesionale, me mjete dhe rrugë juridike. Nëqoftëse do të lejojmë që ky proces të rrjedh sipas rrugëve të zakonshme gjer në fund, atehere aktgjykimi rëndues i të akuzuarve do të jetë jashtë çdo dyshimi. Madje edhe po të shfrytëzohen të gjitha mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme nëpër gjykatat më të larta jugosllave, aktvendimi nuk do të ndryshojë dot, ashtu siç flet fare qartë zhvillimi i ngjarjeve rreth gjykimit "të katershës" para Gjyqit Ushtarak në Lubjanë. Procesin politik kundër A. Vllasit dhe të bashkakuzuarve në rrethanat tonë mund ta eliminojmë vetëm me një mënyrë: është po ajo mënyrë që është përdorur në vitin 1966 për Aleksandër Rankoviqin dhe dy bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë - Svetislav Stefanoviqin dhe Vojin Llukiqin. Atëbotë Kryetari i Republikës, Titoja, shfrytëzoi autorizimin e veçantë që kishte përfalje në formën e të ashtuquajturit abolicion që do të thoshte ndërprerje e menjëherëshme e ndjekjes penale për personat që gjendeshin në procedurë e sipër ndëshkimore edhepse veprimet përfcit kane

qenë të ngarkuar ata tre, nëqoftëse i kanë bërë me të vërtetë, kanë pasur natyrë kriminale.

Në kohën e sotme ky autorizim nga neni 102 i LP të RSFJ i takon Kryesisë së RSFJ, dhe me shfrytëzimin e tij, vetëm ky organ shtetëror më i lartë i Jugosllavise (pra, jo Lidhja e Komunisteve dhe as RS e Serbisë) mund ta shpëtojë në çastin e fundit, jo vetëm nderin dhe autoritetin e Jugosllavise si dhe nderin dhe nderin e autoritetin e secilit anëtar të Kryesisë veç e veç, porse edhe do t'i vinte një digë të fortë fushatës ushtrimit jolegjitim të dhunës dhe ringjalljes të së kaluarës përmes proceseve politike, izolimeve, Goli Otokut dhe të veçorive të tjera të regjimeve totalitariste.

"...Prandaj kurrë mos dërgo për të pyetur se për kë bie kambana: ajo bie për ty." (John Donne, 1573-1631)

Nga "Nashi razgledi" i datës 9. 9. 1989.

Përkthei:B.Elshani

KANGA PËR MILLADININ

Lajm' i zi për derë trokillon,
Porsi zjarmi djeg e përvlon,
Pvesin njerzit me habi:
Si ka mujtë kjo punë me bi?
Milladinin kush e vret,
A vret populli f'minë e vet?!
Milladini nji fjalë flet:
Ajo dorë qi pushk' n'mue qet,
Veç asht dora gjakatare
E fashizmit, dorë tradhtare.
Plag't kullojnë pak nga pak,
N'buzë të vorrit rigon gjak,
Peron ylli me bajrak.
Shok' e shoqe po vajtojnë,
Qajnë e lotët s'u pushojnë,
Qajnë të parin e lirisë,
Mikun trim të vegjëlisë.

Këngë popullore shqiptare

IZTOK TORY: PTICE NA KOSOVU

Nisem pisatelj, a tudi novinar nisem bil. postal sem to čez noč. Nisem niti zgodovinar, tudi politik ne. Izšolal sem se za umetniški poklic in življenjsko pot ubiram med dramskimi replikami ali pa gibljivimi slikami, v katerih se prepletajo visoke filozofske misli z lepimi in grdimi banalnostmi človeških usod. Tako moram biti sredi življenja, brskam globoko po sebi in poskušam razmeti vse okoli sebe...

Nisem pisatelj, tako kot nisem še marsikaj drugega - a pljuniti moram, v to grdo reko, ki je predolgo nosila s seboj. Ta hip čepim na skali...

Reka buta ob skalo. Preliti jo hoče, spodjesti, potopiti. Zlasti njen osrednji tok, ki se najbolj peni...

Po povratku iz februarskega kosovskega pekla sem v montaži skušal izoblikovati nekaj oddaj, ki naj bi razkrile genezo vzrokov za zaplete v tej odročni in do boga zavrnjeni pokrajini. V skladu z zahtevami televizijskega medija sem skušal vso svojo pamet združiti v kratkem in jedrnatem uvodu k prvi iz niza štirih tovrstnih oddaj. A kaj, ko ta uvod nikakor ni hotel biti dovolj kratek.

Posnel sem ga, ga dal na ogled...

Izločil sem ga skoraj v celoti. Danes mi je žal, pustil sem se pretentati, premalo sem se boril...

Oddaje so doživljale odmev, zdi pa se mi, da teh nekaj zdaj že pomečkanih listov rokopisa odgovarja na prenekatero vprašanje sogovornikov.

Prav ta uvod je skala, na kateri čepim...

Ponovno preverjam njeno trdnost: misli, ki sem jih zapisal, doživljajo vsakodnevne potrditve... Čeprav sem jih zapisal za televizijsko rabo, kot nekakšen žurnalistični "fast food" in so verjetno mnogo prepoenostavljeni za strogo znanstveno preveritev, naj gredo vseeno vsaj zdaj na papir, kot dokument mojega razmišljanja v marcu 1989. leta:

- ... Zdaj, ko je kosovska kriza doživelja svoj krvavi klimaks, za katerega se bojim, da še zdaleč ni zaključen, mi ne preostane drugega, kot da vsaj post festum skušam razkriti nekatere silnice, ki so neusmiljeno ustvarjale plodna tla za človeško brezumje. Očitno kljub bližini Evrope 21. stoletja balkansko vozlišče še vedno utripa v okviru vsega balasta plemenske nepomirljivosti in srednjeveškega primitivizma.

Vsa larpurlartistična politična latovščina sodobne Jugoslavije služi le zamegljevanju in ustvarjanju iluzije, da smo v skladu z ideali edinstvenega političnega sistema v svetu, spremenili čisto normalno biološko bitje z imenom Hommo sapiens v povsem novo bitje, ki se zlahka odreže lastnini in utripa le še v ljubezni "bratstva in enotnosti". Za kulisami te socialistične pravljice pa je ves čas potekal le neusmiljen boj za oblast, katerega najbolj smrdljiva oborina je današnje Kosovo.

Ko prebiram vso mogočo literaturo, ki datira tudi v začetek tega stoletja in spoznanja z živo govorico prizadetih v današnjih dneh ter vse to podkrepljujem z množico znanstvenih analiz, se vse razumevanje zoži na lucidno opazko "zahodnega opazovalca", ki jo je objavil londonski "The Independent" in ponatisnilo ljubljansko Delo. Citat: To je konec poglavja v zgodovini kosovskih Albancev. Lahko bi iz njih naredili Jugoslovane. Najbistrejši in najboljši so si to želeli.

Toda nikdar, nikdar ne bodo iz njih naredili Srbe. (konec citata)

Če to opazko prevedemo v še nekoliko bolj neposreden jezik in se miselno priljučim tistim, ki dvomijo v osvobodilni karakter srbskega vojaškega pohoda leta 1912, v prvi balkanski vojni, preko Kosova in Makedonije, ko naj bi osvobajali zibelko svoje državotvornosti, potem vidimo, da vse lakiranje novodobnih oblasti ni moglo prekriti prave barve osnovnega medsebojnega odnosa dveh narodov. Gre preprosto za neprikrit rasizem, ki doživlja svoj fit back. Res je to šokantno spoznanje, zlasti za našo generacijo, ki je ta fenomen poznala le v daljni Afriki in Ameriki, še hujše pa je spoznanje, da smo z njim brezbrinjno živelji v skupni državi vsa ta dolga leta vzpona in padca soorealističnega blefiranja. Ne vem, če smo sami krivi, da nismo vedeli, a očitno smo preveč zaupali tudi naši, slovenski politični oligarhiji, ki je ves ta čas v imenu ideoološke enovitosti neskrupulozno paktirala z nosilci te grozljive politike. Vemo, kdo naših politikov je bil v igri leta 1966 in kdo leta 1981.

Za razumevanje današnje reakcije jugoslovanskih "zamorcev" bi bila načelno zadostna že taka klasifikacija međnacionalnih odnosov, za dodatno razumevanje pa je treba upoštevati še potenciranje klasičnega rasizma s ključem ideologije. "Moralno-politična ustreznost", ki je na Kosovu absolutno izenačena s popolno partijsko ubogljivostjo - kar v nadaljevanju seveda pomeni popolno predanost Jugoslaviji preko Srbije in nič drugače, je selekcijsko sito, skozi katerega se lahko prebije le redki posameznik - pa še ta ne za prav dolgo.

Vem, da se z definicijo, ko na glas izrekam besedo "rasizem", podajam v nevarne vode. A za preveritev naj potrkam na našo podzavest in se vprašam, kakšna je bila naša spontana reakcija oziroma predstava ob besedici "šiptar" še pred kratkim?! Sum se nam je začel vzbujati šele v trenutku, ko so nas iz množice prišlekov nekateri začeli ogovarjati po slovensko, s čimer so nas na nevsiljiv način nekako podkupili! Pred tem pa smo vedeli le to, da je "tam doli" neko nenasitno brezno nesposobnih primitivcev, ki povrh vsega še koljejo kar vse povprek!! Nekritično smo nasedali dobro premišljeni propagandi, ki pa je z arogantno in zaletavo politiko Slobodana Miloševića pokazala svoja rebra. Ta je izza navidez kozmetične ustanove "bitke" za pravico srbskega naroda očitno zavestno uporabila vse že večkrat preizkušene metode. Vzporednice z nekaterimi zgodovinskimi manipulacijami se ponujajo kar same od sebe, a za okvir teh oddaj bi bilo preveč, če bi se spuščali v vse detajle. Zato le v glavnih obrisih skušajmo odstrniti zgodovinsko ozadje, ki je v neposredni zvezi z zadnjimi dogodki. Naj pripomnim, da pri teh zgodovinskih vzhodih narodi in nekdanji vojaki niso ničesar krivi - vedno jih je manipulirala oblast!

-- vsa plemenska prerivanja po Balkanu od Adama pa vse do tega stoletja praktično niso nič nenavadnega, le da so v končni konsekvenčni izoblikovala vse nastavke obeh problematičnih narodov - Srbov in Albancev. Tako v političnem kot kulturnem pogledu. Porajal sta se pač dva zelo različna naroda, ki praktično nista imela nobene prave stične točke - razen ozemlja!!!

-- odločilno za izoblikovanje generalnega odnosa med temi dvema narodoma je obdobje v začetku tega stoletja, zlasti med leti 1912 do 1924. To je obdobje umika Otomanskega carstva v balkanskih vojnah ter obdobje prve svetovne vojne in po njej. Ne da bi hotel zmanjševati

zasluge Srbije v tem obdobju v kontekstu evropske zgodovine, vendar je dejstvo, da je bil angažma srbske politike v tem času hegemonističen v okviru Balkana. Poglavitna prepreka pri doseganju teh ciljev so bili - Albanci, s katerimi je srbska vojska neusmiljeno obračunavala in s pomočjo zaveznikov tudi politično obračunala. Preprečili so, na bojišču in za zeleno mizo, ustanovitev albanske države, ki ji še danes travmatično rečejo Velika Albanija ter si na osnovi zgodovinskega spomina "vrnili" Kosovo in Metohijo. Z ozirom na večinsko prebivalstvo je bila to klasična okupacija, ki si je morala pomagati z vsemi nujnimi radikalnimi prijemi pacifikacije in kolonizacije.

-- z nekaterimi anomalijami predaprilske Jugoslavije, v kateri je prav srbska buržoazija kontinuirano vzdrževala svoj hegemonizem (vključno z Makedonijo in Črno goro!), je hotela nova, socialistična oblast, razčistiti. V veliki meri je Titovi lucidnosti uspelo, delno tudi iz pragmatičnih nagibov, skozi AVNOJ pravičneje urediti mednacionalne odnose. V tistih burnih časih, ko je barka Jugoslavije plula med Sicilij in Karibdo Jalte in Balkanske federacije, v viharju Informbiroja in ekonomske blokade z Zahoda - so bile politične odločitve glede Albancev v Jugoslaviji polne kardinalnih napak in predvsem preprosto prolongiranje starojugoslovanskih metod. Maščevanje za (danes) razumljivo abstinenco Albancev v NOB je bila vojna uprava, nato pa ob zmernem popuščanju, ko se se počasi pričele odpirati prve šole v albanskem jeziku, oster policijski nadzor nad ustvarjanjem avtonomije. Slutnja prihodnosti, ki pa izvira iz historičnega odnosa, je bila strahu polna izjava književnika Miloša Crnjanskega v času akcije razoroževanja Albancev 1955. leta: - Jemljete jim puške, dajete pa jim topove! (konec citata). Da je šola še več kot top, je danes vsakomur jasno.


-- po brionskem plenumu oziroma po letu 1966 je oblast skušala popraviti, kar se je še popraviti dalo. Posegla je v več kot polstotletno dominacijo Srbov na Kosovu in z ustavo iz leta 1974 praktično izoblikovala najpopolnješo avtonomijo na svetu. Albanci v Jugoslaviji so hlastajoče krenili v pomlad svoje polovice naroda, saj si z drugo polovico nimajo kaj pomagat, vsaj v doglednem času ne. Hkrati pa je srbska hegemonistična miselnost doživela strašno klofuto - ki jo je, vsaj tako ta hip misli, z amandmajske ustawo uspešno vrnila...

Tako kratек, tako pomankjiv se mi zdi zdaj ta takrat tako predolg uvod. A kako v nekaj besed stisniti tako obilico misli in prizadetih čustev? Ranjeno dušo... Kako? Ni medijsko.

oddaje govorijo - a zame še vse premalo. Ljudje sprašujejo...

Ljubljana, 12.10.1989

Iztok Tory



IZTOK TORY:

Z O G J T È N È K O S O V È

(fragment dorëshkrimi)

(Iztok Tory, regjisior nga Lubjana, po përgatit një libër mbi përjetimet e mbresat e veta kur, me qëllim përgatitjeje të një vistre emisionesh për TV Lubjanën mbi Kosovën e nga Kosova, i rastisi të jetë dëshmitar i ngjarjeve të papritura të nëntorit të vitit të kaluar dhe të shkurtit të këtij viti. Në librin që do të ketë të njëjtin titull-Zogjtë në Kosovë-sic e patën disa emisione të cilat megjithatë i inçizoi, autori përmes një përjetimi personal çnyjezon paraqitjen dhe shkaqet e rrethanave jonormale, të cilat ashtu apo kështu fusin në opinionin jugosllav brengë e shqetësim. Po botojmë një pjesë nga libri që po lind)

Nuk jam shkrimtar po as gazetar nuk kam qenë. U bëra i tillë brenda një nate. Nuk jam historian dhe siç nuk jam as politikan. Jam shkolluar për një profesion artistik dhe rrugën time jetësore përpinqem ta harmonizoj mes dialogjeve të dramës dhe fotografive lëvizëse, në të cilat gërshtohen mendimet e thella filozofike me banalitetet e bucura ose të shëmtuara të fateve njerëzore. Kështuqë më duhet të gjendem në qendër të jetës, të rrëmih thellë në vetvete dhe të përpinqem të kuptoj çdo gjë për rrëth.

Nuk jam shkrimtar, ashtu siç nuk jam edhe diçka tjetër, ndërsa të pështyjë kam nevojë, në atë lumë të ndytë, që për një kohë as te gjate më barti me vete. Në këtë çast po qëndroj i përkulur mbi bregun shkëmbor...

Lumi godet shkëmbin. Dëshiron ta mbulojë, ta kafshojë, ta përblyt. Sidomos vala e tij qëndrore që po shkumbëzon aq shumë!...

Pas kthimit nga xhirimi i ferrit kosovar të shkurtit, gjatë punës rrëth montazhit kam provuar t'u trajtë disa emisioneve që do të duhej të zbulonin zanafillën e shkaqeve të konflikteve në atë krahine të largët nga e cila, si duket, edhe zoti i ka çuar duart. Në pajtim me kërkesat e mediumit televiziv, pranova që gjithë mençurinë time ta përqëndroj në një hyrje të shkurtër dhe thelbore në të parin nga katër emisionet që kishin tematikë të njëjtë.

Por ç'të bësh kur ajo hyrje s'donte se s'donte të dilte mjaft e shkurter!

E inçizova, bëra një provë...

Pothuajse e shkëputa të tërën. Sot më vjen inat pse kam lejuar lejuar të më gënjejnë, ngaqë është dashur të përpinqem më shumë...

Emisionet bënë jehonë, mirëpo më duket se ato pak fletë të dorëshkrimit, tashmë të zhbroshura, jepin përgjigjet e duhura në disa nga pyetjet e bashkë biseduesve.

Pikerisht ajo hyrje është shkëmbi ku qëndroj i përkulur...

Sërisht po i provoj fortësinë: mendimet e shkruara

atëherë vazhdimisht po i vërteton koha... Ndonëse i kam shkruar për nevoja të televizionit "fest foodi" zhurnalistik, madje ndoshta janë si tepër të thjeshtësuara për t'u bërë ballë ndonjë shqyrtimi të rreptë shkencor, sidoqoftë po i hedh tani të tëra në leter si një dokument të arsyetimit tim gjatë marsit të vitit 1989:

...Tani kur kriza kosovare e përjetoi edhe klimaksin e saj të përgjakshëm, të cilët kam frikë se as për së largu nuk i shihet fundi, nuk më mbetet gjë tjetër pos që së paku si post festum, të provoj t'i ndriçoj disa shtytës që në mënyrë të pamëshirëshme krijuan truall të përshtatshëm për çmendurinë njerëzore. Është e qartë se megjithatë se afërsinë gjeografike me Evropën e shek. 21, nyja gordiane ballkanike gjithnjë pulson në masat e të gjitha ngarkesave të përqarjeve fisnore dhe të primitivizmit mesjetar.

I gjithë zhargoni politik lartpurlartist i Jugosllavisë së sotme ndodhet në shërbim të mjegullimit dhe të krijimit të iluzionit sipas të cilit ne jemi ata që në pajtim me idealet e një sistemi politik unikat në gjithë botën, qenien e thjeshtë biologjike normale me emrin Homo sapiens e kemi shëndërruar në një qenie të një lloji fare të ri, e cila fare lehtë heq dorë nga e vetja dhe fare lehtë pulson në dashurinë e "vëllazërim-bashkimit". Ndërkaq në prapaskenë të kësaj përralle socrealiste vazhdimisht zhvillohej lufta e pamëshirëshme për pushtet, produkt më kutëbonjës i së cilës është Kosova e sotme.

Kur e lexoj gjithë literaturën e mundshme, që daton edhe nga fillet e këtij shekulli, dhe ato njoħuri i krahasoj me bisedat e gjalla të oratorëve të zellshëm të kohëve të sotme, pastaj kur të gjitha ato i përforcoj me një sërë analizash shkencore, i gjithe përfundimi përmblidhet në vërejtjen lucide të një "vrojtuesi përendimor" që e publikoi gazeta londineze "The independent" dhe e ribotoi më vonë "Delo"-ja e Lubjanës. Citati: "Eshtë fjala përfundin e një kapitulli në historinë e shqiptarëve të Kosovës. Ata mund t'i bësh lehtë jugosllavë. Më të mirët dhe më të mençurit këtë edhe e dëshiruan. Mirëpo kurrën e kurrës nuk mund t'i bësh ata serbë" (fund i citatit).

Nëqoftëse këtë vërejtje do ta përthenim në një gjuhë pak më të drejtëpërdrejtë dhe nëqoftëse u bashkohemi pikëpamjeve të atyre që dyshojne në lidhje me karakterin çlirimtar të ekspeditës ushtarake serbe të vitit 1912 gjatë luftërave ballkanike nëpër Kosovë dhe Maqedoni me ç'rast kinse serbët kanë çliruar djepin e shtetformimit të tyre, atëherë mund të shohim se e gjithë bojatisja e pushteteve të reja nuk ka mundur të mbulojë ngjyrat e vërteta të raporteve reciproke themelore në mes dy popujve. Thjesht është fjala përfundimtë racizëm të hapur që tani po e përjeton - fit beckun- e tij. Është me të vërtetë një zbulim tronditës, sidomos përgjeneratën tonë, që një fenomen të tillë e ka njoħur vetem përmes praktikave shoqërore të Afrikës së largët dhe Amerikës, dhe një zbulim akoma me i keq është fakti se me këtë fenomen ne kemi jetuar të shkujdesur, në një shtet të përbashkët gjatë gjithë këtyre viteve të gjata të ngritjes dhe rënies së bllokut soc-realist. Nuk e di se sa jemi fajtorë vete që nuk kemi ditur këtë gjë, mirëpo është e qartë se i kemi besuar së tepërmë edhe oligarkisë politike sllovene që gjithë këtë kohë,

në emër të njëfarë uniformiteti ideologjik ka bashkëpunuar në mënyrë të paskrupullt me bartësit e një politike të tillë të neveritshme.

E dimë mirë se kush nga politikanët tanë ishte në lojë në vitin 1966 dhe kush me 1981.

Për t'i kupuar reaksionet e tanishme të "zezakëve" të Jugosllavisë, parimi shi do të mjaftonte një klasifikim i tillë i raporteve ndërnacionale, mirëpo për një të kupuar më të thellë do të duhej të merrnim parasysh potencimin e racizmit klasik bashkë me çelësin ideologjik. E ashtuquajtura "përshtatshmëri moralo-politike" që në Kosovë nënkupton absolutisht dëgjueshmërinë e plotë partiake- e cila më tutje nënkupton perkushtimin e plotë ndaj Jugosllavisë, porse vetëm përmes Serbisë dhe assesi ndryshe, është një sitë seleksionuese nëpër të cilën mund të përvendet ndonjë individ i rrallë- po edhe ky jo për shumë kohë.

E di se me këtë definicion dhe sidomos kur me plot gojën e shqiptoj fjalën "racizëm" mund të bie në ujëra të rrezikshme. Ndërkao për ta vërtetuar këtë le t'i drejtoshem pak ndërdijes sonë dhe le ta pyes se çfarë ishte reagimi ynë spontan, gjegjësisht qëndrimi ynë kundrejt fjalës "shiptar" vetëm pak kohë me parë?! Dyshimi filloj të na lindë vetëm në çastin kur nga vargu i ardhacakëve të shumtë, disa filluan të na drejtohen në gjuhën tonë në gjuhën tonë sllovene, dhe me këtë rast, në një formë të paimponueshme, na bënë për vete! Më parë kemi ditur vetëm se "atje poshtë" diku gjendet hon i pangopur njerezish primitivë dhe të paaftë, të cilët në mes tjerash, nuk bëjnë gjë tjetër veçse therin gjithçka rrëth e rrotull'! Në një mënyrë fare jokritike kemi rënë ne grackën e një propagande të menduar mirë e cila vetëm me politiken e vrullshme dhe arrogante të Slobodan Milosheviqit na i tregoi brinjët e veta. Ajo pas luftës kushtetuese-kozmetike në dukje, për të drejtën e popullit të vet, me vetëdije të plotë i ka përdorur të gjitha ato metoda kaherë te provuara. Përçasjet me disa manipulime të mëherëshmenë histori janë të pashmangshme, mirëpo për suazat e këtyre emisioneve do t'ishte gjë e tepëruar po të lëshoheshim në të gjitha hollësitë. Ne do të provojmë prandaj që vetëm në vija kryesore t'ia heqim perden asaj prapavije të afërt historike që është si një lidhje më të drejtëpërdrejtë me ngjarjet e fundit. Më duhet të tërheq vërejtjen se në këto leva historike vetë popujt si dhe ushtarët nuk mund të jenë aspak fajtorë-gjithmonë me ta manipulonte pushteti!

-dyndjet gjithëfisnore nëpër Ballkan, që prj Adamit e deri në shekullin tonë, praktikisht nuk paraqesin asgjë të jashtëzakonshme, përveç që , në konsekuençë të fundit, u kanë dhënë formën të gjitha degëzimeve të të dy popujve më problematikë-serbëve dhe shqiptarëve, si në aspektin politik, ashtu edhe në atë kulturor. U linden kështu dy popuj fare të ndryshëm nga njëri tjetri, të cilët praktikisht nuk kanë pasur asnje pikëtakimi të vertete -përveç territorit!!!

-një rol vendimtar në ndërtimin e raporteve të përgjithshme midis këtyre dy popujve periudha e fillimit të këtij shekulli, sidomos ajomes vitesh 1912 e 1924. Është kjo koha e perëndimit të perandorisë turke në luftërat ballkanike si dhe periudha e Luftës së Parë Botërore dhe pas saj. Nuk dua këtu t'i

pakësoj meritat e Serbisë në atë periudhë në kontekstin e historisë evropiane, mirëpo është fakt i pamohueshëm se angazhimi i politikës serbe në atë periudhë në suaza ballkanike ishte hegemonist. Pengesë kryesore për realizimin e qëllimeve të saja në atë kohë ishin shqiptarët, me të cilët ushtria serbe i qëroi hesapet egërsisht, ndërsa me ndihmën e aleatëve edhe politikisht. Ajo (politika serbe, shën. i përk.) e pengoi si në fushë të luftës ashtu edhe në tryezën e gjelbërt, themelimin e shtetit shqiptar, të cilin edhe sot në mënyrë traumatike e thërrasin Shqipëria e Madhe, dhe në bazë të një kujtese historike "iakthyen" Kosovën dhe Metohinë Serbisë. Mirëpo në bazë të faktorit etnik ose të popullsisë shumicë ajo gjë ishte thjesht një pushtim klasik të cilin është dashur ta mbëhtesin me të gjitha masat e nevojshme radikale të pacifikimit dhe të kolonizimit.

- me disa anomali të Jugosllavisë së para prillit, në të cilën pikërisht borgjezia serbe e mbante në vazhdimësi hegemonizmin e saj (duke përfshire këtu edhe Maqedoninë dhe Malin e Zi) pushteti i ri socialist dëshiroi t'i qëronte hesapet. Në një mase të madhe luciditetit të Titos i shkoi përdore, pjesërisht edhe për shkaqe pragmatike, që me anë të KACKJ-së t'i rregullojë më drejtë disa raporte ndërnacionale. Në atë kohë shterngate, kur varka jugosllave lundronte mes Skiles e Haribdes së Jaltës dhe Federatës Ballkanike, në qendër të stuhi së Informbirosë dhe të bllokadës ekonomike perëndimore-vendimet politike për fatin e shqiptarëve në Jugosllavi ishin përplot me gabime kardinale, dhe para së gjithash, një vazhdimësi e thjeshtë e metodave të Jugosllavisë se Vjetër. Për shkak të abstenimit (tani) të kuptueshëm të shqiptarëve në LNC, me qëllime hakmarrëse u vendos në Kosovë administrimi ushtarak, dhe paskëtaj, gjatë lëshimit pe gradual, kur filluan të hapeshin ngadalë edhe shkollat e para në gjuhën shqipe, u vendos një mbikëqyrje e rreptë policore mbi mënyrën e realizimit të autonomise. Një parandjenjë e së ardhshmes, që e ka burimin në raportet historike, është deklarata plot frikë e shkrimit tarit serb, shqiptuar në kohën e aksionit të çarmatosjes së shqiptarëve më 1955: Po ua rrëmbeni pushkët por po ua jepni topat(fund i cit.). Se është shkolla edhe diç më shumë se topi tani është përtë gjithë e qartë.

-pas Plenumit të Brioneve, gjegjësisht pas vitit 1966, pushteti provoi të korrigjonte atë që mund të korrigjohej. Filloi të rrezikonte dominacionin më shumë se gjysmëshekullor te serbëve në Kosovë dhe me kushtetutën e vitit 1974 praktikisht iu dha forma autonomisë më të fortë në botë. Shqiptarët e Jugosllavisë u nisen me vrull drejt pranverës së gjysmës së tyre të popullit; gjysmës tjetër s'ka ç'ti ndihmojnë. Njëkohësisht mentaliteti hegemonist serb mori një dackë të tmerrshme- të cilën me amandamentet e reja në kushtetutë(së paku në këtë çast mendojnë kështu), e kryen me sukses...

Aq e shkurtër dhe aq e mangëtmë duket tani ajo hyrje aq e gjatë në atë kohë. Po si mund të fusësh në një ngushtice fjalesh një begati të tillë mendimesh dhe ndjenjash përplot me preokupacione? Zemër e plagosut...Si? Nuk ka medium.

Emisionet flasin- por për mua sërisht pak. Njerëzit pyesin...



LOTË TË NOSTALGJISË PUSHTUESE

(Plotësimë artikullit *Vremena ljubavi i mrznje të Ljubisa Obradovic-it*, të botuar në "Svet" nr. 192 të datës 23. VIII 1989)

Rrethana që në shtypin e verdhë bulevardesk të Beogradit gjendet vend edhe për artikuj të fryrë me frymë e nostalqji për shekujt e pushtimeve e të robërimit; të kohës së zhupanit të madh serb Stepan Nemanja e të carit të mëpastajmë Dushanit s'është kurrëfarë çudie. Porse çdokush e ka të qartë se ç'fshihet pas artikujsh të tillë dhe çfarë buzëqeshje e llogaritur për fund fshihet pas lotëve që derdhen për gjoja shtypjen e serbëve në Kosovë, në Kroaci, Maqedoni, Greqi, Rumani, Hungari e veçmas në Shqipëri. Territori në të cilin po u shtrika ajo popullatë e "gjorë" e shtypur jugoserbe është madje edhe më i madh se territoret të cilat në gjithë shekujt pushtues të zhupanëve, knjazëve e carëve i qenë përngjitur Serbisë. Edhe në artikullin e Lj. Obradovic-it shkëlqen me të gjitha ngjyrat e saj "shpirtmadhësia" e pushtuesve modernë serbë të cilët në njëren anë mohojnë ekzistimin e kombeve malazeze e maqedonase, porse në anën tjeter luajnë rolin e "mbrojtësve" të atyre minoritetave në Greqi, Kosovë, Bullgari e Shqipëri. Po ajo garnitura punëtorësh kulturorë e shkencorë që tani e sa decenie përpilen të përvetësojnë kolosin e letërsisë kroate Marin Drzic dhe e cila tek kroatët e të gjitha kohëve shohin serbëvrasës luàn tani rolin e "vëllait" të madh sllavoserb për t'i mbrojtur të drejtat e minoritetit kroat e bile edhe atij slloven në Austri, Hungari e në Itali. Është pltësisht e qartë se kur gatuhet një kulaç aq i madh propagandistik domosdo do të ndodhë që përbrenda tij të ketë edhe kundërthënie që hetohen lehtë.

Dhe pikërisht nga ato të meta transparente qet krye hipoteza që mund të mbështetet me të dhëna se garnitura e serbomëdhenjve modernë sikur synon tjetërsimin e historisë së Ballkanit dhe ta realizojë kështu në vepër termin qëllimkeq gjeografik Gadishulli greko sllav (nënkupto-serb) të cilin e kishin lansuar dhe e përdornin disa etnologë rusomëdhenj në vitet '20 të shekullit tonë ose siç do të mund të thuhej sot me një buzëqeshje ironizuese se ata do të dëshironin të krijonin një perandori ballkanike e cila do të quhej Jugoserbi.

Natyrisht që kjo garnitura është më e zhurmshme kur ka të bëjë me sulm mbi shqiptarët dhe sidomos mbi shtetin e tyre emë. Duke qenë se bota e di nëse Shqipëria e shtyp ndonjë minoritet dhe sa e fortë është ajo moralisht që edhe duke injoruar me heshtje shkrimet ala "Vremena ljubavi i mrznje" i zhvleftëson ato. Së këndejmi plotësimet e mia artikullit të Obradovicit nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen e shtetit tim emë porse që me dromca nga historia e shqiptarëve dhe ajo e pararendësve të tyre-ilirëve autoktonë që edhe këta i patën përjetuar vrushkujt e gjakut, gjuhët e zjarreve e kundërmimin e kufomave të pavarrosura që i shkaktuan pararendësit e Obradovicëve kur në trojet tona erdhën si masa pushtuese, të prira nga avarët pët tu vendosur në këto anë dhe për të marrë për detyrë t'i dëbojnë e t'i shfarosin të

gjithë- jo vetëm ata në Kosovë.

Eshtë një tragjikë morale kur e vërteta e hidhur e detyron njeriun të kete frikë se as historiani më i politizuar ose shpirtqetësues nuk mund të gjejë në asnje arkiv pikëmbështetje për të dëshmuar se si qeveritë serbe patën vetëm një herë qëndrim korrekt ndaj shqiptarëve. Kjo e vërtetë, madje, del edhe nga teksti i Lj. Obradovicit. Fillet e terroritnisin me ardhjen fiseve sllave në Ballkan. Historiani serb St. Stanojević shkruante në librin e tij Vizantija i Srbisë se në vigjilien e penetrimit me dhunë të sllavëve në Ballkan, për shkak të luftërave të shumta që ishin zhvilluar në këtë truall në shekujt 3 e 4, disa krahina të Ballkanit ishin shkretëruar. "Regjione të tëra ishin të shkreta; arat ishin të pambjellura dhe qytetet ishin braktisur nga banorët e tyre. Iliria ishte e shkretë; edhe Thrakia si dhe Dardania dikur e pasur ishin shkretëruar; shumë regjione ishin braktisur; fushat kishin mbetur të papërpunuara dhe të mbuluara me skelete të banorëve të mbetur. Në viti 548 ndodhi sulmi i sllavëve, me ç'rast si rëndom nuk kursyen askend dhe, që kur u ndodhën në territorin bizantin, s'patën asgjë tjeter në mendje përveç se secilin që ka rënë në pushtetin e tyre ta mbysin. E gjithë Iliria dhe Thrakia ishte e mbuluar me kufoma të pavarrosura. Prokopi dëshmon se sllavët nuk i thernin viktimat e tyre me shpatë ose me thikë, porse i ngulnin të gjallë në hunj që t'i lënë kështu të vdesin nën mundime të tmerrshme" thotë Stanojević.

Fatin e këtyre ilirëve dhe ballkanasve tjerë autoktonë të cilët nuk e përjetuan "mirëseardhjen" e përgjakshme, me zjarr e të akullt të pushtuesve të rinj-pararendësve të zotëri Obradovićit nuk është vështirë ta imagjinosh. Këtë përpigjet ta imagjinojë akademiku serb P. Ivić i cili në librin e tij Srpski narod i njegov jezik (Beograd 1971, f. 24-25) shkruan: "Kur kataklizma e invazionit sllav rrezikoi ekzistencën e popullatës së gjetur aty, një pjesë e saj gjeti strehim në qytetet e fortifikuara bregdetare, ndërsa një pjesë tjeter u tërroq në male. Burimet e mangëta historike nuk përmbyjnë shënimë mbi tragjedinë që solli ky ndryshim i tillë i mënyrës së jetesës, porse imagjinata jonë mund të ndihmojë kollaj të kuptojmë ç'deshi të thoshte t'i braktisësh qytetet dhe fshatrat e rregulluara, stilin e jetës në të cilin shpesh kanë gjetur vend edhe shkrim-leximi, edhe teatri, edhe kanalizimi e banjo dhe të përpigjet t'i adaptohesh blegtorisë nomade nëpër kodrina të pakapërcyeshme, merret vesh duke iu kthyer primitivizmit dhe analfabetizmit të plotë".

Me tragjikën ilire përkatësisht me kataklizmën e botës romake në territorin e sotëm gjuhësor të shqipes humbi vazhdimësia e organizimit shoqëror të antikës. Meqë Ilirikue veçanërisht Dardania edhe në kohën e lulëzimit, zenitit të perandorisë romake ishte në të vërtetë zonë periferike e perandorisë në aspektin kulturor, dyert e asimilimit (së pari të romanizimit pastaj të sllavizimit) qenë jo pak, por hapekrah të çelura. Mirépo, nëse nuk pati kushte kulturore e sociale për vazhdimin e rregullimit romak të jetës e të shoqërisë e kompenson këtë faktori njerëzor shqiptar i këtij nënqielli i cili mbeti bartës i kontinuitetit etnik i periudhës antike. Shqiptarët e Dardanisë nuk kanë mundur

të jenë bartës të kulturës së lartë antike por ata qenë vetëm etnos i cili ruajti dhe vazhdoi vetëm karakteristikat etnike të ruajtura nga antika dhe asgjë tjetër: as forcën e pushtetit as format e vjetra të rregullimit shqëror.

Jo vetëm nga teksti i Obradovićit (khs. f. 33) rezulton qartë se historia e serbëve është në të vërtetë një histori e ngulimeve me dhunë, e kolonizimeve, e pushtimeve. Prandaj për t'i humbur këto gjurmë ata lansuan teza nga më të papranueshmet përkitazi me historinë e shqiptarëve për t'ia vënë majen me falsifikimin e historisë mbi gjoja zbritjen eshqiptarëve nga malet dhe kolonizimin nga ata të Kosovës dhe viseve të tjera ku jetojnë që nga antika shqiptarët në Jugosllavinë e sotme. Arsyetimin provizor i kësaj teze pseudoshkencore ata u munduan ta mbështetin mbi ndonjë shpërngulje të serbëve e cila është fryrë aq shumë (madje edhe më shumë se gjoja shpërngulja e serbëve në këtë dhjetëvjetëshin e fundit nga Kosova) sa ka kaluar në një legjendë.

Qëllimi i pseudoshkencarëve ishte dhe është me prapavijë politike. Këta përpigen edhe sot t'ia mbushin mendjen opinionit evropian se shqiptarët janë aty popull që paska zënë vend duke e shtrenguar atë serb që të shpërngulet për t'i arsyetuar kështu vrasjet, prerjet e shpërnguljet me dhunë në Anadoll; lënien në analfabetizëm dhe kthimin e shqiptarëve në qytetarë të rendit të dytë në tokën e stërgjyshërvë të tyre ilirë. Të gjithë Obradovićët donë të harrojnë se shqiptarët janë populatë autoktone, parasllave në Ballkan; se madje djepi i formimit të gjuhës shqipe (si zhvillim i natyrshëm nga gjuha mëmë e saj-ilirishtja) është pikërisht Dardania me Shqipërinë e Veriut dhe të Mesmen. Të gjithë ata harrojnë se me ardhjen e tyre në trojet ilire-shqiptare ndërprenë një proces kulturor dhe rrënuan një civilizim i cili, pa dyshim, qe në shkallë më të lartë dhe më i butë nga ai që turmat ardhëse i sollën me vete.

Për të përligjur pushtimet, Obradovićët duan të kapën për shterpësinë e burimeve me të cilën karakterizohet periudha bizantine dhe nga kjo shterpësi burimesh donë ta mohojnë ekzistencën e shqiptarëve në viset në të cilat edhe sot jetojnë brenda republikave të Serbisë, Maqedonisë e Malit të Zi. Ata porse harrojnë se pikërisht pararendësit e këtyre shqiptarëve ishin të nënshtruarit e Romës dhe fqinjët e parë e të stërlashtë të grkëve të vjetër; se këta ishin qytetarë të Bizantit edhe në shek. 11 e 12 kur Vukanët e Stepan Nemanjat e shtetit malor të Rashkës sulmonin Lipjanin përkatesisht Obradović harrojnë se Nemanja ua ka lënë për testament fjalinë më 1198 "dhe nga toka greke (nënkupto: bizantine) pushtova Lipjanin dhe Llapin, ndërsa nga Shqipëria të dy Pultat". Ishin të zbrazëta këto vise kur i pushtoi Nemanja?

Dr. SKËNDER GASHI - Vjenë

BALLË PËR BALLË ME PASOJAT E GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME NË KOSOVË (I)

Në fund të shtatorit një delegacion i Federatës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ishte në Kosovë. Delegacioni i kryesuar nga gjyqtari në zë parisien Antoine GARAPON dhe nga avokatja londinezë, aktiviste e shquar në fushën e mbrojtjes së të drejtave njerëzore Louise CHRISTIAN si dhe i nënshkruari nën këtë raport u nis nga Lubjana dhe të dielen pati një bisedë të frytshme në zyrën e avokates së njojur beogradase Tanja PETOVAR. Kjo është aktive në Grupin e punës të Konferencës së Helsinkit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut për Beogradin dhe e udhëheq atë. Përndryshe i nënshkruari e njeh personalisht në bazë të një angazhimi solidar të saj në gjykimin në Pejë në qershori të vitit 1986. Prandaj s'është aspak e çuditshme se me t'u takuar dhe në të ndarë shkëmbyem puthje të vakëta shqiptaro-serbe... Tanja ka plotë klientë shqiptarë që përgjigjen para ligjit për bindjet e tyre politike. Pikerisht, atë të diel tek ajo gjendej një djale nga Peja, i vëllai i ushtarit Ilir Nallbani që kohë më parë ishte dënuar nga Gjykata ushtarake me 10 vjet burg. I vëllai kishte ardhur për vizitë dhe kur nuk e kishte gjetur Ilirin në burgun e Beogradit dhe duke mos marrë përgjegje nga drejtuesit e Burgut se ku gjendet kishte ardhur të interesohet mos dinte gjë avokatja e tij se ku e kishin shpënë atë...

Dy evropianët interesoheshin për opinionet e beogradasve që erdhën një nga një në zyrën e saj për të thënë edhe ata se ç'mendojnë për gjendjen e të drejtave të njeriut në Jugosllavi. Përshtypje e përgjithshme ishte se jugosllavët nuk mund të lavdërohen në këtë fushë të rëndësishme të demokracisë e të shtetit ligjor. Të gjithë ishin të mendimit se në Kosovë aktualisht shkelen me të madhe nga ana e shtetit të drejtat njerëzore të shqiptarëve. Porse, edhe serbëve u ndodh kjo me një ndryshim se shkeljet që u bëhen shqiptarëve është lehtë të argumentohen kurse te serbët jo, ngaqë shkeljet bëhen në mënyrë perfide...

*

Në mbrëmjen e 24 shtatorit jemi në Hotelin Grand Prishtina. Na pret punë e madhe nesër. Rruga e gjatë dhe e mundimshme ka bërë të vetën. Pothuaj nuk shohim gjë. E në mengjez derisa hame kaftjallin unë përpigem të bind evropianët se nuk gjendet në këtë hotel Shtabi Suprem i APJ...

(flasin punëtorë mjeksie)

... numri i të vdekurve në mars nuk do të dihet kurrë... organet e punëve të brendshme nuk kanë dhënë numrin e saktë, përndryshe spitalet në Kosovë u kanë dorëzuar gjithë dokumentacionin institucioneve përkatëse... viktimat më të mëdha ishin në viset më të varfëra të Kosovës së varfér... janë të shumtëta arsyet: ka familje që anëtarin e tyre e kanë varrosur pa lajmëruar askë duke u siguruar kësodore nga vizitat e policisë dhe keqtrajtimet e tjera... shumë punëtorë shëndetësie i diferencojnë pse gjoja kanë ndihmuar të plagosurit dhe kanë

siguruar barëra për punëtorët grevistë...disa i përjashtojnë nga puna...

(flasin punëtorë arsimi, arti shkencë e kulture)

...këtu zbatohen forma të ndryshme të shkeljes së të drejtave të njeriut...p.sh. këtu kërkohet dhe zbatohet kriteri përshtatshmërisë moralo-politike si kusht për punë të ndryshme publike: shkollim, punësim...këtu ekzistojnë lista të njerëzve të padëshiruar që s'mund të paraqiten publikisht...ekziston cenzurim preventiv në shtyp e mjete të informimit...këtu s'mund të botojmë atë që botojnë në republikat tjera...këtu aplikohet izolimi moral i njerëzve, përgjohen dhe mbi ta aplikohet shkalla më e lartë e frikësimit; mendimi tjetër këtu quhet mendim armiqësor...megjithatë, me këto masa jemi mësuar dhe i konsiderojmë pothuaj të zakonshme, si shtypje të mendimit kritik. Këto kanë traditë këtu, por viteve të fundit ne përjetojmë forma të reja të cënimit të drejtave të njeriut-diferencimin që zgjat qe 8 vjet. Ky, dmth. diferencimi, pa marrë parasysh si quhet zyrtarisht, është një masë ndëshkuese morale dhe praktikisht sociale. Diferencimi ka lënë shumë njerëz pa punë. Shumë njerëzve ua ka marrë të drejtën të drejtën të jenë në organet drejtuese, në arsim, kulturë, ekonomi e fusha të tjera. Diferencimi ka lënë shumë nxënës e studentë pa shkollë. Diferencimi sjell edhe përulje të dinjitetit të njeriut duke u vënë kusht atyre ose të heqin dore nga mendimet e veta ose do ta pësojnë. Diferencimi është praktikisht një denuncim e spiunim kolektiv. Duhet të diferencohesh prej mendimeve, ndonjëherë prej babës, vëllaut, motrës, mixhës e prej kujt bie puna. Izolimi...Juristët, shumica thonë se është jokushtetutar. Izolimi është praktikuar edhe më 1981, por atëherë s'ka guxuar kush të flasë pë këtë problem...Prap tek diferencimi. Ai është presion mbi ndërgjegjën kombëtare...Në mjetet tona të informimit mund të flasësh vetëm çfarë dëshiron burokracia politike...ata që i largojnë nga partia mund t'i largojnë edhe nga puna...çdo ditë shtypi (Rilindja, Jedinstvo, etj.) lajmëron për njerëz mbetur pa punë...Izolimi është praktikisht forma më brutale e diferencimit-dhuratës tragjike të bolshevizmit, këtu e përpunuuar më mirë se në burim. Në fatin e pakicave kombëtare shumë shpikje bolshevikë kanë marrë përmasa brutale. Në Jugosllavi sot s'ka diferencim pos për shqiptarët në Kosovë e në Maqedoni...Pos izolimit në burg që ka traumatizuar shumë njerez, ekziston edhe një izolim tjetër-izolimi i familjes në bazë të Kanunit...p.sh. ka familje që janë shpallur të dyshimta, të cilave s'guxon kush tu shkojë në shtëpi e as t'i pranojë në shtëpi. Këtë formë të izolimit e ka aplikuar pushteti. Diferencimi dhe izolimi ka traumatizuar shumë: shumë kush ka pritur se do ta izolojnë, me vite presim se do të na diferencojnë...Shumë punëtorë, profesorë, gazetarë, shkrimtarë, regjisorë janë thirrë në polici dhe shumë prej tyre kanë nënshkruar deklarata...Në shkurt ka qenë Apeli, përmes të cilët është kërkuar të mos ngushtohet pozita autonome e Kosovës. Këtë Apel që praktikisht ka mbrojtur Kushtetutën në fuqi, politika e shpalli armiqësor...Një numër nënshkruesish janë thirrë në polici dhe janë detyruar të jepin deklarata. Këtu

zbatohet mbikqyrje mbi njerëz... Policia ka mbledhur diskutimet mbi kushtetutën... Përgjimi i telefonave, kontrollimi i postës s'na bën më përshtypje... Në Maqedoni shqiptarëve u ndalohet të ndërrojnë vendbanimin... nuk mund të blejnë shtëpi në Shkup as në Ohër... fëmijëve nuk guxojnë t'u vënë emra nacionalë... Në Serbi stimulohet nataliteti, në Kosovë përgatiten masa kundërtij... Të gjitha këto flasin për cënimin e të drejtave të njeriut, të dinjtetit, nderit, humanizmit... Në një varg vendesh në Maqedoni fëmijët nuk mund të shkollohen në gjuhën amtare. Në shkolla të mesme mësimi zhvillohet vetëm maqedonisht. Arsimtarët shqiptarë mbledhjet me prindërit shqiptarë duhet detyrimisht t'i mbajnë në gjuhën maqedonase...

Vjet në shtator në Kuvendin Krahinor e në Këshillin Ekzekutiv është publikuar shifra 583.730 vetëve që janë trajtuar nga ana e policisë-praktikisht çdo i treti. Prej shtatorit të vitit të kaluar ky numër është rritur. 71000 janë ndjekur penalisht, të tjerët janë privuar lirie, janë thirrur, janë mbajtur, u është tërhequr vërejtja... Në këto shifra nuk hyjnë shqiptarët e ndjekur në Maqedoni as në ushtri e në Mal të Zi... Në realitetin tonë ka shumë fate trgjike... Njeriu i dënuar, që ka mbajtur burgun kurrë nuk mund të gjejë punë. Të dhënët e deponuara deri më tanë nuk pëfshijnë edhe periudhën pas aplikimit të masave të jashtëzakonshme... Për pasojë të një gjendjeje të këtillë është shtuar numri i sëmundjeve psiqike, psikotomatike, dështimeve tek gratë, i lindjeve të fëmijëve para kohe, i lindjeve të fëmijëve me defekte të ndryshme. Represioni që ushtron shteti me makinerinë e vet është shumë i rëndë... Nxënësit e studentët shqiptarë pothuaj që tetë vjet nuk ua sheh gjëzimin në fytyrë...

...numri i studentëve në Universitet ka rënë për 53% nga viti 1981... vetëm 64% të nxënësve që kanë kryer tetëvjeçaren sivjet kanë mundur të rregjistrohen në shkollë të mesme... sivjet 180 studentë nga Serbia do të rregjistrohen në Prishtinë, do të vendosen në konvikte dhe do të kenë bursa shteti...

... fabrikat ndërtohen në vendet ku ka serbë. Malisheva, komunë me 50 mijë banorë kryesisht shqiptarë nuk ka asnjë objekt industrial, ndërsa Zubin Potoku, komunë poashtue e re me 7000 banorë kryesisht serbë ka 6 objekte industriale... Nga disa fshatra kanë ndjekur banorët shqiptarë duke u rrënuar shtëpitë (rasti në fshatin Batusë). Fshatarët serbë të fshatit Prilluzhë të kominës së Vuçiternës nuk lejojnë ardhjen e 200 nxënësve shqiptarë të fshatrave përreth për të mësuar edhe më tej në godinën e përbashkët shkollore...

... është mbyllur fare kufiri shkencor i këmbimit me Shqipërinë... këtu pengohet shikimi o programit të RTV Shqiptar edhepse në Shqipëri shikojnë programin e RTV Jugosllav...

... të dhënët e paraqitura në asnjë mënyrë nuk mund të janë të plota sepse është i gjatë njëqind vjet presioni i paramenduar, elaboruar e zbatuar në dëm të qenies kombëtare shqiptare. Kjo që ndodh sot s'është gjë tjeter pos përpjekje që Kosova të serbizohet duke ndjekur shqiptarët nga trojet e tyre shekullore. 250.000 shqiptarë nga 400.000 sa ishin planifikuar me marrëveshjen për shpërngulje me Turqinë u vendosën në atë vend

dhe po të mos shpërthente lufta sigurisht se pamja etnike e sotme e Kosovës do të dukej krejtësisht tjetër. Edhe në epokën e socializmit vazhdoi të vlejë marrëveshja e Mbretërisë...

Salih Kabashi

DEKLARATA E KËSHILLIT EKZEKUTIV TË SHOQATËS PËR INICIATIVË DEMOKRATIKE JUGOSLLAVE

Pas tetë muajsh të zgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë, asnjë nga problemet e qenësishme me të cilat kjo pjesë e Jugosllavisë-si dhe vendi në tërësi-po ballafaqohet me vite, jo vetëm nuk është zgjidhur por shumë prej tyre janë ashpërsuar, derisa përmundësitet e daljes nga situata e tashme as nuk janë në diskutim, ngaqë diskutimi i lirë-së pakut në Kosovë-nuk është i mundshëm. Për shkak të të gjitha këtyre, anëtarët e Këshillit Ekzekutiv të UJDI-së u propozojnë anëtarëve të Shoqatës dhe opinionit më të gjere të angazhohen duke kërkuar dhënie llogari për çdo gjë që ndodhi gjatë tetë muajve të fundit në mënyrë që të kthehem prapa-kah rrënjet e situatës së padurueshme në Kosovë dhe përpara-kah zgjidhja e saj.

Konsiderojmë se kushti i parë përmjet një kthesë të tillë në situatën e tashme është dhënie urgjente e raportit e Kryesise së RSFJ Kuvendit Federativ dhe opinionit më të gjere mbi:

1. bazat kushtetuese e ligjore të veprimit të forcave të sigurimit (ushtarake dhe policore) gjatë muajve të fundit në Kosovë, numrin dhe përbërjen e tyre, përmasat dhe zgjatjen e paraparë të aksioneve të tyre si dhe harxhimet e shfrytëzimit të tyre;

2. të dhënat e sakta mbi të gjitha viktimat e rëna gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme si dhe të dhënat precise mbi rrethanat në cilat ka ardhur deri te vrasja si dhe me procedurën penale kundër civilëve bashkë me mënyrën konstatimit të përgjegjësisë të pjesëtarëve të forcave të sigurimit lidhur me këtë;

3. të dhëna të sakta mbi të gjithë personat e "izoluar" dhe shkaqet e veprimeve të tillë, mënyrën e zbatimit të "izolimit", mbi përgjegjësinë personale të të gjithë atyre që kanë trajtuar jashtë ligjit e sidomos ndaj atyre që, siç thonë raportet e shpallur publikisht, nuk është konstatuar as përgjegjësi penale as kundërvajtëse, kështuqë "izolimi" i tyre ka qenë në kundershtim me normat ndërkombëtare në fuqi, bila edhe në kundërshtim me normat jugosllave;

4. mënyrën e komandimit në aksionet konkrete me forcat e sigurimit dhe personat përgjegjës;

Konsiderojmë se njohja publike e përgjegjes në këto pyetje do të mundësonë vlerësim më të qartë të kushteve në mënyrë që gjendja e banorëve të Kosovës bila të mos keqësohet. Një prej kushteve konkrete përmjet këtë është, gjithësesi, kontrollimi i gjendjes në jurisprudencën e Kosovës. Për këtë shkak do të duhej kërkuar nga Kryesia e RSFJ që të emërojë një grup juristësh në zë (p.sh. Gjorgji Marjanoviq, Ijubo Bavcon, Srgja Popoviq) që do të hulumtonte funksionimin e sistemit juridik dhe me të do të njoftonte opinionin.

Shoqata për Iniciativë Demokratike Jugosllave do të organizojë, po pati mundësi, edhe më tej aksione me qëllim të njohjes së situatës në Kosovë (merret vesh edhe në tërë Jugosllavinë, në mënyrë që para së gjithash në diskutimet, gjasat

për zgjidhje demokratike, për aq sa është e mundshme, të jenë të pranishme në opinion. Fakti se është lëshuar rasti që, siç qe thënë në Deklaratën e Këshillit Ekzekutiv më 26 shkurt- që me **udhëheqje civile federative** të bëhet diç në përmirësimin e situates në Kosovë, edhe më shumë tregon domosdoshmérinë që sa më parë të jetë e mundshme të perfundojë ky episod fatkeq ushtarak-politic që duhet të jetë i fundit në territorin(dhe historinë) e Jugosllavisë.

Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës për Iniciativë Demokratike Jugosllave

Izjava članov Izvršnega odbora za jugoslovansko demokratsko iniciativo v zvezi z izrednim stanjem na Kosovu

Po osem mesecev trajajočem izrednem stanju na Kosovu še nobeden od poglavitnih problemov, s katerimi se ta del Jugoslavije - in država v celoti - sooča že leta, ni bil rešen, še več, mnogi med njimi so se še zaostrili, morebitnih izhodov iz sedanjega položaja pa ni niti v diskusiji, saj svobodna diskusija - zlasti ne na Kosovu - sploh ni možna. Zato vsi člani Izvršnega odbora ZJDI predlagajo članom Združenja in najširši javnosti, naj se angažirajo in zahtevajo čiste račune v zvezi z vsem, kar se je zadnje tri mesece dogajala na Kosovu, da bi naposled lahko šli nazaj - h koreninam nevzdržnih razmer na Kosovu, in naprej - k njihovi razrešitvi.

Menimo, da je v sedanjih razmerah prvi pogoj za tak preobrat takojšnje poročilo Predsedstva SFRJ Zvezni skupščini in najširši javnosti o:

1. ustavnih in zakonskih utemeljitvah delovanja varnostnih sil (vojaških in policijskih) zadnje mesece na Kosovu, o njihovem številu in sestavi, obsegu in predvidenem trajanju njihovih akcij ter o stroških, ki jih to terja;
2. točnih podatkih o vseh žrtvah, ki so padle v obdobju izrednega stanja in natančnih okoliščinah njihove smrti, pa tudi o kazenskih postopkih proti civilistom in o načinu preverjanja odgovornosti pripadnikov varnostnih sil v zvezi s tem;
3. natančnih podatkih o vseh osebah, ki so bile "izolirane" in o razlogih za ta postopek ter o načinu izvajanja postopka "izolacije", o posamični odgovornosti za postopke proti vsem, ki so bili žrtve nezakonitega ravnana, zlasti pa proti tistim, ki jim - kot kažejo javno objavljena gradiva - ni bila dokazana nikakršna kazenska ali prekoračena odgovornost, tako da je bilo njihovo "izoliranje" v nasprotju z veljavnimi mednarodnimi, pa tudi jugoslovanskimi normami;
4. načinu poveljevanja v konkretnih akcijah varnostnih sil.

Menimo, da bi šele javni odgovori na ta vprašanja omogočili jasnejšo presojo razmer, ki so potrebne, da se stanje prebivalcev na Kosovu ne bi vsaj slabšalo. Eden neposrednih pogojev za to je prav gotovo javni nadzor nad pravosodjem na Kosovu. Zato bi morali zahtevati, naj Predsedstvo SFRJ imenuje skupino uglednih pravnikov (npr. Djordji Marjanović, Ljubo Bavcon, Srdja Popović), ki bi preverila delovanje pravosodnega sistema in o tem obvestila javnost.

Združenje za jugoslovansko demokratsko iniciativo bo, če bo to v njegovih močeh, še naprej organiziralo akcije za boljše razumevanje razmer na Kosovu (in seveda v vsej Jugosaviji), da bodo - predvsem v diskusijah - možnosti za demokratično rešitev kolikor mogoče prisotne v javnosti. Izpuščena priložnost, da bi - kot navaja izjava Izvršnega odbora 26.februarja - s civilno zvezno upravo pripomogli k izboljšanju razmer na Kosovu, le še dodatno nakazuje, da je nujno potrebno čimprej končati nesrečno vojaško-policijsko epizodo, ki mora biti zadnja na ozemlju (in v zgodovini) Jugoslavije.

Zagreb, 14.oktobra 1989

Komisioni i Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut rrumbullakësoi përshtypjet pas vizitës në Kosovë

"D Y J U G O S L L A V I "

zbuluan "raste tepër të egra e të numërtat" të shkeljes së të drejtave të njeriut

PARIS, 5 nëntor.-Një Komision i posaçëm i Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut ishte javën e kaluar përvizitë studimore" në Kosovë. Kryetari i tij Antoine Garapon, anëtar francez i kësaj organizate joqeveritare, e cila përndryshe është e akredituar pranë KB, UNESCO-s dhe Këshillit të Evropës, në konferencën për shtyp në Paris deklaroi se delegacioni ka zbuluar raste "jashtëzakonisht të rënda" të shkeljes së të drejtave të njeriut në këtë krahinë jugosllave.


Pas pesë ditë qëndrimi në Kosovë përfaqësuesit e kësaj organizate ndërkombëtare, e cila pos anëtarit francez që përndryshe është gjyqtar në Paris përbëhej edhe nga Louise Christian, avokate nga Londra dhe Salih Kabashi, anëtar i Këshillit Slloven për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë, do të bëjnë raport të posaçëm për komisionet përkatëse të KB, UNESCO-s, Këshillit të Evropës dhe Parlamentit Evropian. Me konstatimet e tyre tashmë kanë njofuar qeverinë franceze, e cila, siç thotë Garapon, "është e të njëjtit mendim".

Kemi zbuluar "raste të rënda e të shumta" të shkeljes së të drejtave njerëzore dhe "dënim te përpjekje me shkeljet. "Ekzistojnë dy Jugosllavi", tha Garapon, "njëra ka vështirësi por jeton normalisht, Jugosllavia tjetër është në Kosovë, ku nuk u përbahen ligjeve të asaj të parës". "Jemi të tronditur për shkak të metodave të vjetruara të represionit e dhunës, derisa as shteti as gjyqet në Kosovë nuk punojnë në të mirë të rregullimit të rrëthanave".

Kryetari i Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut thotë se "nuk është i kënaqur me pritjen në Kosovë" sepse "i ka përcjellë policia" ("formë presioni") dhe se pas "takimeve të shumta" kanë konstatuar se janë të pranishme dy kategori të shkeljeve të të drejtave njerëzore: diskriminim e pabarazi e njerëzve në fushën e arsimimit, kulturës, relacioneve banesore, apo punësimit në bazë të cënimit nacional apo individual që rrjedhin përmes të mekanizmit të diferencimit dhe të mekanizmit të izolimit. Garapon përmendi rastet e "izolantëve" e egërsitë e policisë karshi tyre dhe tha se "procese të tilla administrative pa gjykim publik e pa të drejtë mbrojtjeje" u gjykuat dhe u hodhën poshtë "me presionin demokratik të opinionit" të cilin e vendosi në Slloveni e Kroaci po edhe në Serbi, ku "demokratët" dhe "njerëzit e vullnetit të mirë" nuk pajtohen me cënimin e të e të drejtave të njeriut dhe të cilët "janë të ndërgjegjshëm se është e mundshme që problemet në Kosovë të zgjidhen vetëm në mënyrë demokratike".

Pushteti nuk iu përgjegj kërkësës së delegacionit që të bisedohet me Azem Vllasin dhe me disa të paraburgosur e të burgosur të tjerë "çka është e denjë për pikëllim" thotë Garaponi dhe paralajmëroi se delegacioni do të përcjell gjykimin e "ish-njeriut

të parë të Kosovës" dhe të tjerëve nga grupe i tij dhe do të ngul këmbë që gjykimi të rrjedh në suaza të **Nenit 11** të Deklaratës së Përgjithshme, pra, që gjyqi të punojë pavarësisht, që të akuzuarit të kenë të drejtë të zgjedhin mbrojtjen dhe që gjykimi të jetë publik. "Po qe se delegacioni ynë apo delegacione të ngjashme nuk do të lejohen të hyjnë në sallë të gjyqit, do të perfundojmë se gjykimi nuk ka kurrëfarë vlere ndërkombëtare", shkruan Mirko Galiq në Vjesnik të Zagrebit.



ALUDIME NË LLOGARI TË JUGOSLLAVISË

Gjenevë. 20 tetor-Afera lidhur me eksplodimin ende të pasqaruar, i cili më 12 tetor shkatërrroi një veturë private, që do t'i jetë drejtuar familjes së aktivistit kosovar për pavarësinë e krahinës, edhe më tej bën jehonë në mjetet e këtushme të informimit. Para katër ditësh që të katër gazetat që dalin në Gjenevë, përhapën lajmin mbi eksplodimin, në të shumtën duke alduar, pakashumë haptas, në mundësinë se është fjala për shkaktarë nga radhët e shërbimit sekret jugosllav.

Më së shumti rrëth aferës shkruan gazeta Suisse që sot nën titulli "U bë tepër i rrezikshëm?" kumtoi se bomba i ishte drejtuar Xhafer Shatrit, "autorit të raportit eksplodues mbi shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë, që u prezantua gjatë mbledhjes së 45. të Komisionit të Kombeve të Baskuara mbi të Drejtat e Njeriut, derisa ajo krahinë ishte në vlim të vërtetë, kur Beogradia ia hoq statusin e saj autonom. Raportin që e paraqiti Këshilli i Kosovës për Informimin e Opinionit Botëror, anëtar i të cilit është Shatri, ka rëndësi të premierës historike: për herë të parë pas Luftës II Botërore në OKB u publikuan haptas të dhënët mbi dhunën që ushtron Serbia në Kosovë", shkruan "Suisse" dhe vazhdon: "Që nga ky çast, Shatri, që mbledh e shpërndan informacione mbi gjendjen në Kosovë dhe u dërgon lëvizjeve të shumta për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, afër mendësh, u bë tepër i rrezikshëm për shërbimin sekret jugosllav. Prandaj atentati mbi të më 12 tetor".

Gazeta gjenevase gjithashtu përmend se në mars të këtij viti, pas heqjes së autonomisë së Kosovës, erdhi deri te grevat e demonstratat në gjithë krahinën, po të cilat qenë shtypur me egërsi dhe "morën më shumë se njëqind viktima bile edhe gra e fëmijë". "Dhe derisa kosovaret varrosnin e lidhnin plagët e të plagosurve, televizioni i beogradas krejtonte këtë ngjarje me shampanjë".

Mbi eksplodimin hollësishët njoftuan edheditarin e mbrëmshëm televiziv në frengjishte, i cili ngjarjeve në Kosovë dhe bombës i kushtoi shtojcë të veçantë. Në të intervistuan Xhafer Shatin, të paraqitur si aktivist për autonominë e Kosovës, i cili për një veprimtari të tillë në Jugosllavi ishte dënuar. Pas kësaj në Zvicër mori strehim politik. Në pyetjen e gazetarit se a ndjehet i rrezikuar u përgjegj me po. Gazetari zvicëran që televizioni paraqiti "dosjen Shatri", në fund shprehu mendimin se në rast se akuzat mbi përzierjen e shërbimit sekret jugosllav tregohen të vërteta, do të vijë deri te ftohja e marrëdhënieve midis shteteve. C'është e vërtetë rrëth kësaj çështjeje e çka jo, do të konstatojnë në hetimet zyrtare, por s'duhet harruar se përfaqësuesit tanë zyrtar akuzat se është fjala për aksion të shërbimit sekret jugosllav-Suisse përmend Sigurimin Shteteror, bila Udben-der tash nuk i kanë demantuar në opinion. Gazetarët zvicëranë që kanë provuar të marrin mendimin e përfaqësive diplomatike jugosllave, në Misionin e përhershëm pranë OKB-së kanë marrë pohimin se thashethemat mbi atentatin e shërbimit tonë sekret plotësisht të pabaza. Gazetarit të Courrierit të këtushëm në ambasadën e Bernit iu përgjegjen me qeshje të zëshme dhe falënderim për njoftimin.

Bozho Mashanovic
(DELO, 21 tetor)

LAJM I GËZUAR

Kohë më parë, në të përditshmet e Prishtinës e të Lubjanës, në Rilindje dhe në Delo, Fakulteti Filozofik i Universitetit Edvard Kardel të Lubjanës, shpallën të lirë vendin e punës së lektorit të gjuhës shqipe.

Siq bën me dije shërbimi përkatës i Fakultetit Filozofik, Komisioni për Marrëdhënie Pune, mori vendim që në vendine e lirë të punës të pranohet prof. dr. Rexhep Ismajli, i lindur në Preshevë, më 6.6. 1947. Në arsyetimin e Vendimit thuhet se Rexhep Ismajli është profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqiptare si dhe doktor i shkencave filologjike. Në konkursin e shpallur morën pjesë 25 kandidatë, në mesin e të cilëve ishin 21 që i plotësonin kushtet e konkursit. Rexhep Ismajli u pranua sepse:

- më 1971 mbaroi studimet në Prishtinë;
- studimet nga linguistika e përgjithshme i kreua tek prof. Martine në Paris e ato të gjuhësisë krahasimtare në Bochum;
- më 1982 doktoroi me temë nga historia e gjuhës shqipe;
- prej vitit 1972 e tutje punon në Katedrën e Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Kosovës në Prishtinë dhe ka titullin përkatës të profesorit të Lingistikës së përgjithshme dhe të Historisë së gjuhës shqipe;
- është autor i tekstit Gjuha shqipe për të huajt, etj...

*

Padyshim, një krah i fortë i studimeve shqiptare po transferohet në Veri. T'i gëzohemi këtij fakti dhe Rexhep Ismajlit t'thërrasim: Mirë se erdhe dhe punë e mbarë.

FJALA numër 16 e 15 shtatorit sjell këto tekste: "Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe" të Androkli Kostallarit, letren e transkriptuar nga studjuesja frënge Odette Marquet (Odet Marke) me titullin "Të dhëna të reja ngajeta e Pjetër Bogdanit". Studjuesi i veprës së Bogdanit, Ibrahim Rugova shkruan për "Idetë astronomike të Pjetër Bogdanit", ndërsa Fazli Syla për "Elemente të letërsisë gojore në veprën e Bogdanit". "Toponimet dhe antroponimet në veprën e Pjetër Bogdanit" është tekst i Rexhep Doçit. Ragip Mulaku shkruan për "Prapashtesat zvogëluese në veprën e Pjetër Bogdanit".

*

MURAT ISAKU:SHTJELLA(roman)

Në romanin "Shtjella" portretohen fatet e njerëzve të vegjël që frymojnë periferive të jetës. Me një realizëm të kulluar jepen fytyrat plastike të personazheve Lul Kalulit (violinist që kërkon punë në një kafe-restoran privat, Zonjës Rrezellinë që punon si banakiere në po këtë këtë kafe-restoran, pas peripecive jetësore nëpër të cilat e kanë hedhur valët e dekonverzacionit me rrethin, botëkuptimet dhe paragjykimet e tij, me të cilën Lul Kaluli vë marrëdhënie spontane nëpërmjet rrëfimeve të jetës së njëri tjetrit që ia tregojnë duke dashur kështu të bëhet ai njësimi i fateve tragjike, etj.), Imer Llaçit, pronarit të kafe-restoranit,

fytërës që bie në dekadencën e gllabërisë materiale dhe që përqafon pa masë doket e reja të një jetë të shthurur, njeriut që pas varfërisë dhe bredhjeve fatkeqe nëpër botë, ndarjes me gratë dhe shterpësisë jepet në amullinë e alkoolit et. etj....

----- * -----

Ivan Klemençiq nga Lubjana u ankua për një cenzurim që i paskan bërë ata të Delos. Në të vërtetë, në një letër që batoi Mladina shihet se letra dërguar të përditshmes i qenka botuar pa këto fjalë:

"Don të thotë se: Banorët shqiptarë të Kosovës duhet të kenë të drejtë të plotë të shprehen për formën e vet të jetesës, ashtu siç duhet ta kenë këtë të drejtë gjithë popujt në Jugosllavi. Po deshën shqiptarët e Kosovës republikën, le ta kenë republikën, po deshën bashkëngjitje me Shqiperinë, le ti bashkohen Shqipërise. Vetëm një zgjidhje kësodore është e drejtë, afatgjate dhe më pak e dhembshme. Të gjitha zgjidhjet e dhunshme do të janë tragjike e të përgjakshme, por edhe për zullumçarët, gjë që dëshmon fati i popullit të lajthitur gjerman".

ANTONIO BELLUSCI: DIZIONARIO FRASEOLOGICO DEGLI ALBANESI D'ITALIA E DI GRECIA

Arbërorëve në Greqi Arbëreshëve në Itali Shqiptarëve në Shqipëri Kosovarëve në Jugosllavi Aronautëve në Turqi kudo ndodhen kudo janë me zemër e dashuri

Ky është përkushtimi i autorit të Fjalorit frateologjik arbëresh-arberor të përkthyer në italisht, anglisht e frengjisht. Kjo vepër e rëndësishme ka lindur si rezultat i një pune shumë të lavdërueshme shkencore vjelë në terren - në 115 katunde arbërishtfolëse të Italisë e të Greqise.

Disa fraza arbëreshe:

Buk e qep/e mb' shpit tënde.

I dha shpirtin t' Ligut.

Pula banë venë/e gjelitë i dhembë bitha.

Barin çë ngë do/ te kopshti bihet.

T'kam si gjemb ndër si.

Më mirë të kesh një mik/se shumë parë.

Ea, të të puth një çikë/lle ti haj ullku dhitë.

ALBANO NË SHQIPERI

Në javën e parë të tetorit i bënë një vizitë Shqipërisë këngëtar i njohur italian **ALBANO KARIZI** me të shoqen **ROMINA**. Kur zbriti në limanin e Durrësit Albano puthi tokën shqiptare day herë. Në pyetjen e gazetarit të "Adriatikut" mos është zakon i tij të puth tokën kudo vete për vizitë Albano tha: Kjo është hera e parë! Një herë e putha për babanë që vdiq në luftën e fundit në Shqipëri dhe një herë për vete...

Përndryshe Albano dha një varg koncertesh nëpër Shqipëri ku entuziazmoi publikun artdashës shqiptar. Këngët e tij janë një

angazhim i fuqishëm kundër luftës dhe në të mirë të mirëkuptimit midis popujve e dashurisë mes njerezve. Një ndër ato këngë ishte edhe kënga Saranda.

"KONTAKTI" I PARË I ALTERNATIVËS ME POLICINË

Enver NEZIRI, kolporteri i Alternativës tashpërtash është i parinë ekipi i revistës sonë që "ishte mysafir në polici". Në Pule, qytetin bregdetar kroat "u zu" duke shitur këtë material për policinë të dyshimtë. Prandaj, policët i futën krahun dhe nja 9 orë i kaloi në bisedë te "përzemërt" ku duhej të bente përshkrimin e brendshëm e të jashtëm të anëtarëve të redaksisë. Në ndërkohë punonte lidhja e teleksit Pule-Lubjanë dhe në fund iu dha (v)iza të shkojë po për kujtim ia ndalën edhe 170 ekzemplarë të 3-4-shit.

Përndryshe Enveri është në formë të mirë dhe ngul këmbë që krahas studimeve të anglishtes do të hulumtojë tregun për Alternativën. Të na rrojë Enveri!

Redaksisë së ALTERNATIVËS i vijnë gjithnjë më shumë letra nga lexuesit dhe dashamirët e saj jo veç sllovene e shqiptarë. Letrat flasin për hallet tona të përbashkëta dhe kanë një porosi të përbashkët: qëndroni në rrugën e nisur, jemi me ju! Kur lexon fjalë të tillë, dalë nga shpirti, s'ke si të mos jesh krenar dhe i obliguar që edhe më shumë të angazhohesh që fletushka jonë e re të përbush kërkosat jo edhe aq të vogla që shtrohen para saj.

Në vërejtjet për letrat e lexuesve të botuar vetëm sllovenisht në numrin 3-4 të Alternatives, është thënë se letrat do të bisten por redaksia përban të drejtën e shkurtimit pa cënuar as përbajtjen as porosinë themelore të shkruesit. Letrat do të bisten me adresë të plotë e kur vete shkruesi don të nënskruaj me pseudonim kjo do të tumiret. Po redaksia duhet ta ketë adresën e plotë. Natyrisht se dëshirë jona dhe e lexuesve tanë është të jetojmë në vendin ku nuk do të ketë nevojë për pseudonime dhe anonimitet.

LETRA MË E DASHUR !

HORA E ARBËRESHËVET, 19.8.1989

Shumë i dashur bashkatdhetar Salih Kabashi, mora revistën "ALTERNATIVA": kudo që të mbahet ndezur një zjarr për çështjet tona, atje është edhe mendimi im, zemra ime e vepra ime: jam me ju! Sapo fillojme prapë botimet e revistës sone "MONDO ALBANESE" do të jap lajmin e lindjes së revistës "Alternativa", e do të batoj edhe paraqitjen tuaj.

Mbahuni fort! Urime e suksese!

Të fala vëllazërore

GIUISEPPE SCHIRO DI MAGGIO

(nënskrimi)

P.S. Ju dërgoj botimet e mia të fundit.

DY LETRA NGA FSHATI

...Më pëlqen emri i revistës suaj e besoj edhe tonës. Le ta ketë jetën e gjatë dhe duam ta kemi në duart tona. Suksese!...

Latif Daka, fshati Vërshec-Duhël

Lajmi për themelimin e Shoqatës Kulturore Shqiptare të pagëzuar me emrin e poetit tonë të mirën johur MIGJENI, më gëzoi shumë. Veç tjerash funksionimi i shumë seksioneve në kuadër të kësaj Shoqate, veçanërisht i atij letrar dhe nxjerra e "ALTERNATIVËS", është vepër mjaft e mirë dhe vlerëmadhe që i kontribuon zhvillimit të jetës së pergjithshme kulturore të shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë në Lubjanë dhe në mbarë Slloveninë po që njëherit i shërbën afri se popullit shqiptar dhe popullit slloven.

Haxhi Muhamxheri

Kosuriq, Baran-38307

NGA ZVICRA

Në fletushkën tuaj ALTERNATIVA gjeta pjesën e Atdheut tonë. Me këtë rast ua ofroj ndihmën time në përkthimet nga sllovenishtja ngase fati ka dashur që të kem kryer shkollën filllore në Slloveni. Ju përvendos!

Mentor Merturi

Rte Principale 15

2824 Vicques-Suisse

Të dashur shokë, kemi kënaqësinë e veçantë që të ju përgëzojmë për nismën tuaj të mbarë dhe të mirë duke ju dëshiruar suksese në këtë punë sa patriotike aq edhe njerëzore. Ne punëtorë shqiptarë me punë të përkohshme jashtë atdheut me shqetësim të madh po i përjetojmë tragjeditë dhe fatkeqësitë e njëpasnjëshme që po godasin vëllezërit dhe motrat tona...

Që në numrin e parë të ALTERNATIVËS suaj që na ra në duar e të cilën e lexuam me entuziazëm të madh, duke shpresuar se ky nuk do të jetë numri i fundit, mund të themi se gjetëm materiale të cilat kënaqën kërshérinë tonë lexuese dhe interesimin për një informim të drejtë dhe objektiv mbi shqiptarët në Jugosllavi, ngase sot për sot askush nuk mund të mbylli sytë e të hesht para tragjedisë kosovare.

Disa punëtorë me punë të përkohshme jashtë atdheut

Shënim: Dëshirojmë të na dërgoni revistën rregullisht në këtë adresë:

Demë Jashari
Pension Wilhelm
Rue de Marche 13
CH-1820 Montreux

I dashur Sali,

Numri i parë i ALTERNATIVËS arriti edhe në Suedi. Kjo i gëzoi jo vetëm anëtarët e rinj të Shoqatës "Kosova", por edhe ne të tjerëve që jemi më pleq po që gjithmonë kemi dashur gjërat që bien erë të freskët. Jemi të kënaqur jo vetem me bashkëpunëtorët shqiptarë, po edhe me ata sllovenë. Ekipi është i shkëlqyeshëm, tani duhet ta bëni edhe punën e shkëlqyeshme. Unë mergimtari plak i viseve veriore të Evropës ju uroj sukses nga zemra dhe këtë gjë po e bëj si në Shoqatën "Kosova", ashtu edhe në valët e një emisioni që e përgatisim një herë në javë. Shqiptarët e kësaj anë e priten revistën mirë, madje kopjuan disa numra që ti shesin e tu ndihmojmë materialisht...

Të fala të përzemërtë
Ramadani

Adresa e Shoqatës:

Albanska kultur forerningen Kosova, BOX 18118, 20032 Malmö

NGA GJAKOVA

Në këto kohëra të progresit e krizës, formimi i Shoqatës Kulturore MIGJENI në Lubjanë, do të lë gjurmë të pashlyeshme në historinë e popullit shqiptar dhe popullit slloven...

Mexhid Yvejsi
Ruga Musa Zajmi 47
38320 Gjakovë

Bijtë e Vargjeve të lira marshojmë mbi krahët e shqipes drejt drites dhe lirisë! Lexova Alternativën 2, çdo fjale e saj na shuan etjen që na ka kapluar. Mos e hudhni në shportë këtë letër se është shkruar me zemër.

Qerim H. Krasniqi
(absolvent i Gjuhë-let. shqipe që punon privatish në G.I.P. Ingrad-Nova betonarska, 63210 Slov.Konjice.

NGA NORVEGJIA

Të dashur bashkatdhetar, para ca kohësh na ra në dorë fletushka juaj. Ju uroj më suksese. Dërgomëni revistën në këtë adresë:

Shabi Muharremi
POST BOKS 172
OYSTESE 5610- NORGE

LETËR E NJË TË IKURI

Lep pozdrav! Do të përpigemi t'u ndihmojmë materialisht që të mëkëmbeni dhe të dilni rregullisht. Falenderojmë popullin e ndershëm, bujar dhe human të Sllovenisë.

S. HASANAJ, Suedi

NGA MITROVICË E TITOS

Lajmi për themelimin e SHKSH "MIGJENI" me të gjitha degët (seksionet) e saj dhe botimi i revistës "Alternativa" në këto dite e kohë, kur kulturës shqiptare dhe fjalës shqipe këtu në Kosovë dhe Maqedoni i është zënë fryma dhe ditaditës po i merret shpirti, është, jo vetëm një sihariq, por edhe një fitore e madhe, sidomos kur të kihet parasysh vendi ku ndodh kjo mrekulli dhe populli vëlla, në gjirin e të cilit u mundësua një veprimtari e këtillë kaq e nevojshme për një popull fisnik e me traditë liridashëse, bijtë e të cilit për kafshatë të gojës jandegëzuar anëmanë Ballkanit, Evropës dhe botës. Do të dëshiroja që me guxim të vazhdoni rrugën e filluar, si simotrat tuaja të atij vendi të frysës së lirë. Do të dëshiroja, poashtu, të bëhem lexues i rregullt i saj, po edhe bashkëpunëtor sipas mundësisë...

Ju deshiroj punë të mbarë me suksese të mëdha-i juaj:

Jakup Ceraja
Rr. 21 nr. 14 "Tavnik"
28220- Mitrovicë e T.

NGA SUEDIA

Ju ngjattëjeta vëllezër! U mahnitëm me fletushkën tuaj të mrekullueshme që doli në momentin më të duhur për shqiptarët që jetojnë në Slloveni dhe jashte. Urojmë suksese nga zemra. Shumë shqiptarë të Suedisë. Suksese!

Resturant Pizzeria
K O S O V A
Kungsvägen 45, Bergkvara

NGA ShBA

Për Shoqatë Kulturore Shqiptare MIGJENI dhe për fletushkën ALTERNATIVA mësova nga shkrimet në shtypin amerikan... Urojmë të vazhdoni me sukses punën e filluar dhe duam të na e dërgoni revistën.

Kujtim QAFA

Abedin Shaqiri:

NESREČNA USODA ALBANSKEGA NARODA

Na jugu naše države se zadnjih osem let dogajajo neznosne žalostne scene v škodo albanskega naroda. Ko na severu naše domovine cveti večstrankarski sistem - pluralizem, albanski narod na Kosovu živi v najprimitivnejših razmerah in v hišah, narejenih iz blata. Srbom in Črnogorcem sta zagotovljena zaposlitev in stanovanje, albanskemu delavcu pa je za isto prošnjo potrebno čakati deset let ali pa sploh ne pride v poštev za stanovanjske pravice. Znano nam je, kaj se je dogajalo ob agrarni reformi, ko so albanskemu narodu na Kosovu odvzeli zemljo, ki so jo dali srbskim kolonistom. Ko so spoznali, da na Kosovu zanje ni prihodnosti, ter se zavedli, da žive na tuji zemlji, so se začeli odseljevati tja, od koder so prišli - ti dogodki se nadaljujejo do današnjega dne. To velja za umazano politiko "vodje" Miloševića, ki mu taka situacija ne ustreza. Propadel je njegov poskus, da bi na vsak način prepričal svetovno javnost z lažmi, kot da se Srbi izseljujejo zaradi albanskega pritiska in terorja. Po zaslugi pravice in resnice iz mnogih krajev naše domovine in celega sveta so ljudje spoznali, da je resnica popolnoma drugačna. Kosovo in naša širša socialistična domovina je ognjišče vseh ljudi, ki žele živeti pošteno in brez sovraštva v škodo enega ali drugega naroda. Žalostno, da velikosrbska politika ne vidi nič pozitivnega znotraj albanskega, slovenskega ali hrvaškega naroda...

Ljudje, ki nikoli doslej niso živelni na Kosovu, dobe stanovanje in zaposlitev, in to brez vsakršnega razpisa, na nezakonit način, kosovska mladina pa vzame pot pod noge in odide v razne evropske dežele iskat zaposlitev in svojo srečo. Zahtevam, da se vsi albanski delavci vrnejo v svojo ljubljeno ožjo domovino, da se zaposle v organizacijah združenega dela, da so ob svojih družinah, zato ker samo tam sta njihova volja in njihova sreča.

KATËR KONCERTE TË SUKSESSHME TË SEKSIONIT MUZIKOR TË
SHOQATËS KULTURORE SHQIPTARE M I G J E N I TË LUBJANËS

Brenda një muaji grupi folklorik dhe ai dramatik i Shoqatës sonë dhanë, po na besuat, hiç më pak se katër koncerete: dy në Lubjanë e nga një në Nova Goricë e në Maribor. Të katër koncertet i panë afër tre mijë veta. Publiku që kryesisht përbëhej nga shqiptarët e shumtë me punë në Slloveni si dhe sllovenë e pjesëtarë të nacionaliteteve tjera të Jugosllavisë si dhe studentë të vendeve tjera që shkollohen në Lubjanë a në Maribor. Kërkesat për të dhënë koncerte të reja janë të shumta dhe gatishmeria e djelmoshave e vashave poashtu është mahnitëse. Me këtë rast duhet lavdëruar punën pothuaj profesionale të udhëheqësve artistik të grupit muzikor dhe të atij dramatik, **Mefail Hysenit** dhe **Skënder Fazliut**. Cfarë të thuhet për këngëtarët e këngëtarët **Ali Dobruna**, vëllezërit **Zabelaj**, **Remzie Sinani**, **Arjeta Kabashi** e shumë të tjerë që me këngët për Kosovën, Bacë Bajramin, Luigjin, Isanë me dy alltia, Sefë Kosharen e këngë të tjera për dashurinë e vrullin rinor. Në koncertin e fundit u këndua edhe kënga prë Migjenin e autorit **Halil Berisha**, që përndryshtë është përkthyes i shqipes në sllovenishte. Të përmendim se Halili ka përkthyer pothuaj të romanin **Sikur t'isha djale** të Haki Stërmillit dhe i ka hyrë me zell punës që t'a bëjë **Kadarenë** të flasë sllovenisht (përkthen **Kështjellën**). Vallja shqiptare e njohur u luajt për mrekulli nga **Shërbim Elezkurtaj** dhe **Remzie Sinani**.

Suksesit të programit i ndihmuan shumë musafirët nga Zagrebi: **Ana Lekaj**, **Afërdita Dragaj**, **Zhaklina Berisha** dhe **Ferhat Ymeri**.

F. DEMIRI

**FJALA E NAIM MALOKUT, KRYETARIT TË SHOQATËS KULTURORE
SHQIPTARE M I GJ E N I TË LUBJANËS MË 30 SHTATOR 1989 NË SHTËPINË
E KULTURËS "LUFTËTARËT E SPANJËS" NË LUBJANË**

Bashkatdhetarë dhe miq të nderuar!

Është nder i madh për mua kur më jipet rasti tu përshëndes në emër të Shoqatës sonë, që u themelua para tre muajsh në po këtë sallë. Që nga dita e parë u aktivizuan të gjitha sektionet e saj:

- Seksioni letrar me fletushkën ALTERNATIVA që nuk bën ta quajmë fletushkë, revistë të mirëfilltë e të pavarur të Shqiptarëve, që lexohet në tërë botën- atje ku ka shqiptarë dhe dashamirë të shqiptarëve;

- Seksioni muzikor që, ja, sot po paraqitet me koncertin e parë;

- Seksioni dramatik me skeget e para dhe me një monolog po bën hapin e parë. Besojmë se së shpejti do ta luajmë edhe HALILIN E HAJRINË;

- Seksioni sportiv me 20 lojtarët e tij po ushtrojnë lojën e futbollit dhe së shpejti do të marrë pjesë në turne e gara tjera. Vullneti i tyre është i madh dhe pas punëve të ditës ushtrojnë me rekizitat që i blejnë vetë me të ardhurat e tyre të vogla.

Shoqata jonë jeton dhe vepron nga kontributet materiale që nga goja e tyre i ndajnë punëtorët shqiptarë me punë në Slloveni dhe vise të tjera të Jugosllavisë. Është një rast i përshtatshëm që tu falënderohemi të gjithë atyre që na ndihmuani të vijmë deri këtu.

Besojmë se së shpejti do të arrijmë që të fillojmë me mësimin e gjuhës shqipe për voglushët shqiptarë në Lubjanë. Kësodore lusim të interesuarit që të paradesin emrat e adresat e atyre që kanë fëmijë dhe dëshirë të mësojnë gjuhën e nënës në Lubjanë.

Le të jehojnë këngët dhe çiftelite!

UJDI PAQEJE

Urrejtja e mosdurimi midis pjesëtarëve të popujve të RSFJ kanë arritur pikën e vlimit. Disponimi i masave mund të sjell ngjarje të paparapara po të njohura në histori. Jemi dëshmitarë të luftës psikologjike në RSFJ e ka një vjet nga kërcnimet me armë. Hapësirës sonë do t'i shërbente zëri i betimit të pakusht të atyre që nuk kanë humbur njerëzishmérinë në furtunë të urrejtjes së valëvitur. Me të betuar tek njëri tjetri do të ngjallnim besimin e ndërsjelle dhe siguri se njëri tjetrit në asnjë rast nuk do t'i sillnim të keqe.

Lusim miqtë dhe njerëzit e vullnetit të mirë që nuk i janë nënshtuar përhapjes së urrejtjes, t'i bashkohen nënskrimit të ujdice të paqjes midis qytetarëve të kombeve e të kombësive të ndryshme dhe ua propozojmë një variant të përbajtjes së kësaj ujdie.

Ujdia e paqjes obligon çdo nënskrues/se që kudo ta shoh të nevojshme të nderoj përbajtjen e saj.

Disa mundësi teknike për nënskrimin dhe përhapjen e ujdice të paqjes

Tipet e ujdice paqësore

1. **Ujdi individuale**-midis dy njerëzish nacionalitetesh të ndrshme; mund ta bëjnë ujdinë duke formuluar vetë përbaj-

tjen e saj dhe duke shkruar vetë sipas ndërgjegjes dhe bindjeve të veta, apo individualisht a në çift nënshkruajnë ndonjë nga variantet tashmë të te botuara.

2. **Ujdi familjare**-midis anëtarëve të dy amë shumë familjesh; tekstin e bëjnë vete apo përdorin ndonjë ekzemplar tanimë të njohur që u përgjigjet.

3. **Ujdite grupore**-një tekst e nënshkruan grup njerezish; tekstin e formulojnë vete apo përdorin ndonjë shëmbull që u konvenon.

Variantet e përhapjes së ujdive paqësore

Fotokopjen e ujdisë dhe teksteve përcjellës mundet kushdo pranon ujdinë ta shpjere më tej dhe t'ua dërgojë miqve, edhe ai që e refuzon poashtu mund ta dërgojë e shpjere tutje. Poashtu mund t'i bashkohen nënshkrimeve të çfarëdo varianti të ujdive grupore.

Ujdite paqësore kanë funksion të dyfishte

1. në hapësirat ku komunikimi midis përfaqësuesve të nacionaliteteve të ndryshme është i vështirësuar në të gjitha nivelet, ujdite paqësore sëndertojnë dhe ruajnë ato fije të holla po të rëndësishme të rrjedhës së energjisë e të marrëveshjeve;

2. në hapësirat ku mediumet, politika e njerezit në bisedat e përditshme mbushin me stereotipe të refuzimit e të gjykimit të përfaqësuesve të kombeve e të kombësive tjera, ujdite paqësore realizojnë e ruajnë format e mendimit, të pranimit e kuptimit të njërezores tek çdo njëri nga ne.

Nga ky shkak është e rëndësise vendimtare që ujdite paqësore të shpallen në mediumet dhe ashtu të ta bëjnë të ditur **vendimin e betimin** e njerezve që getas e me arsyen të komunikojnë.

Për këtë qëllim, dërgoni kopjen e ujdisë mediumeve lokale dhe në adresën:

Ljudje za kulturo miru/
mirovne pogodbe
SKUC, Kersnikova 4
61000 Ljubljana

Njerëzit e kulturës së paqjes do të përpilen
ti batojnë ujdite dhe të jepin informacione
të tjera.

Ujdinë mund t'ua dërgoni miqve tuaj, të njohu-
rve dhe përgjithësisht kujt dëshironi.

UJDI PAQEJE

Me të nënshkruar të kësaj ujdie obligohem:

1. se me asnjë kusht nuk do të marr pjesë në
kurrëfarë veprimi të armatosur apo tjetërfarë
veprimi dhune kundër pjesëtarëve të popujve të
tjerë apo banorëve të tjerë të RSFJ;

2. se me asgjë nuk do të bashkëpunoj në përgati-
tjet në çfarëdo veprimi të represionit, dhunës
a shtypjes të orientuar kundër banorësh tjerë të
RSFJ.

3. se, në rast se pushteti lokal a federaliv do të
më detyrojë në çfarëdo veprimi nga i cili kam he-
qur dorë në dy pikat e mëparshme, pa kusht do të
kundërshtoj përmes metodash të pa dhunë të mospër-
dellimit civil e të moskondisjes qytetare;

4. se në jetën e përditshme do të përpiqem që të për-
mbahem në shprehje mendimesh, ndjenjash e veprimesh
që sjellin përapjë urrejtjeje ndaj pjesëtarëve të
popujve tjerë; do të përpinqem të heq dorë nga kallë-
zimi i barcoletave, shqiptimit të gjykimeve të për-
gjithshme apo kualifikimeve në llogari të njerëzve
si pjesëtarë të popujve tjerë;

5. se do të shfrytëzoj të gjitha mundësitë, në jetën e
përditshme dhe publike, për tejkalimin e shprehjes së
urrejtjes ndaj pjesëtarëve të popujve tjerë dhe se ku-
do që do të gjendem do të përapjë frymën e marrëveshjes,
durimit e mirëkuptimit.

Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë
Le comité pour la défense des droits de l'homme en Kosovë
23, Rue d'Albanie
Bruksel

**Kuvendit të RSS,
kryetarit të Kuvendit Kombëtar të RS të Sllovenisë**

Zonja, zotërinj,

duke pasur parasysh se gjendja e sotme në jug të Jugosllavisë, veçanërisht në Kosovë ku mbreteron një paqe e rreme e represionit policor, u bën të pamundshme shqiptarëve të Jugosllavisë, që jetojnë në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e në Serbi, të shprehin besnikërinë e tyre demokracisë pluraliste sipas modelit slloven,

duke pasur parasysh se udhëheqësit e tashë të Kosovës nuk mund t'i konsiderojmë përfaqësues legjitim të banorëve të Kosovës, pasiqë për ardhjen e tyre në pushtet duhet t'u falënderojnë ndryshimeve në Kushtetutë më 23 mars 1989, të imponuara me dhunë e dredhi, ndryshime të cilat Serbia i zbatoi përkundër vullnetit të pjesës më të madhe të banorëve të atjeshëm,

duke pasur parasysh të gjitha këto Komiteti i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë, të cilët nuk kanë mundësi të shprehen lirisht, i lejon vetes të përgëzozë popullin slloven dhe qeverisë së tij për guximin e tyre dhe vendosmërinë se do të udhëheqin vetë me fatin e vet dhe do të vazhdojnë-përkundër gjithë përpjekjeve të frikësimit nga ana e forcave që me mall duan të kaluarën-në rrugën e demokracisë e pluralizmit, dy qëllimeve që puqen me vizionin e Jugosllavisë, nënskruese të Kartës së Helsinkit dhe me parimet bazë të Kushtetutës së saj. Pasiqë kushtetuta përcakton Jugosllavinë si shtet shumetnik shumënational(Neni 1), mendojmë se askush(pos shpirtit të sëmurë) nuk mund të mohojë, se është conditio sine qua non për mirëqenie dhe gjallim të një shteti asisoji të rregulluar, paqja midis etnive pakicë e shumicë që e përbëjnë-paqe që nuk mund të mendohet pa nderim të ndërsjellë, barazi de iure e de facto, pa vetëvendosje e pa nderim të kujdeshëm të të drejtave njerëzore e qytetare: veçorive më fisnike të demokracisë pluraliste.

Zonja e zotërinj, pranoni dëshirat tona më të sukseshme që veprimi juaj novator të ketë sukses në gjithë Jugosllavinë.


Enver Hadri
për
Komiteten për Mbrojtjen e
të Drejtave të Njeriut në
Kosovë

Bruksel, 2 tetor 1989

Nga pëmbajtja e ALTERNATIVËS numër 5:

IZTOK TORY
Dr. LJUBO BAVCON
SALIH KABASHI
JURE DETELA
Dr. SKËNDER GASHI
Dr. AGIM VINCA
STERJO SPASSE
MIRKO GALIQ
JASHA ZLLOBEC
TANUSH TORBARI
BOZHO MASHANOVIQ
BAJRAM KABASHI
JAKUP CERAJA
MIKEL GOJANI
ARIF KUTLESHI
MARTIN CAMAJ
ALI PODRIMJA
GANE TODOROVSKI
DEMË JASHARI
BUJAR KODRA
ZDRAVKO DUSHA
ISMET HYSENAJ
ABEDIN SHAQIRI
MIGJENI
HAKI STERMILLI
BAJRAM KABASHI
JURE DETELA

PTICE NA KOSOVU-ZOGJTË NË KOSOVË
PËR KË BIE KAMBANA
BALLË PËR BALLË ME PASOJAT...
DISKRIMINIMI I FËMIJËVE NË TETOVË(II)
LOTË TË NOSTALGJISË PUSHTUESE
60 VJET ME PENË NË DORË
NGA SHËNIMET E NJË DIOGJENI TË RI
"DY JUGOSLLAVI"
TË PËRBASHKËTA DHE TJERAFARE
MARSHI I BARABAJT
ALUDIME NË LLOGARI TË JUGOSLLAVISË
DËBIMI I PAPËRSHTATSHMËRISË
PRANVERËS SLLOVENE
LUIGJ GURAKUQIT
KUTIA E PANDORES, DASHURI DHE VDEKJE
LAHUTA
ZOTI TË DHASHTË
GJER NË VRAZHDALLE DHE PRAPË
DUKE KUJTUAR VENDLINDJEN
LULET E GJAKUT
ARMIKU NË KRAHËT E DEMOKRACISË
NEZNOSNO STANJE ALBANSKEGA NARODA
NESRECNA USODA
POEMA REVSCINE
KO BI BILA DECEK
STIMULIRANJE NEPISMENOSTI
DISKRIMINACIJA OTROK V TETOVU
LETRA TË LEXUESVE
PISMA BRALCEV
LAJME





ALTERNATIVA

Fletushkë e Seksionit Letrar të **Shoqatës Kulturore Shqiptare MIGJENI** - Lubjanë
Glasilo literarne sekcije Kulturnega drustva Albancev v Ljubljani **MIGJENI**

Kryeredaktor-Glavni urednik:

SALIH KABASHI

Redaktor përgjegjës-Odgovorni urednik:

MATJAZ HANZEK

Redaksia-urednistvo:

Jasa Zlobec, Bislim Elshani, Zdravko Dusa, Fadil Demiri, Peter Bozic, Shkëlzen Maliqi, Matjaz Hanzek, Halil Berisha, Salih Kabashi.

Botoi-izdala: UK ZSMS Ljubljana, për të-zanjo: **Gorazd Drevensek**

Shtypi-Natisnil: ZUSGP Ljubljana

TOZD Ucne delavnice

Bezigrad 8, Ljubljana

Përgatitja-oprema: Matjaz Hanzek
Salih Kabashi

Adresa e përkohshme e Shoqatës dhe e revistës-zacasni naslov drustva in glasila:

**ZVEZA KULTURNIH ORGANIZACIJ
/ALTERNATIVA/**

MESTNI ODBOR

Krekov trg 2

61000 LJUBLJANA YU

Kontributet vullnetare dhe parapagimin mund ta bëni në xhiro-llogarinë-Prostovoljne prispevke lahko posljete na ziro racun:

LB 50101-678-47303, në adresën-na naslov:

UK ZSMS-LJUBLJANA-ALTERNATIVA SM 20700

Cmimi-cena: **50.000 din.**

**Lexonie,
shpërndanie e
ndihmonie ALTERNATIVËN!**

